



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve /Departman Poljoprivrednih Politika i  
Trgovine/Department of Agriculture Policy and Trade

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arhivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive	
Nr./Br./No.	918
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	62
Data/Datum/Data:	04.03.2022
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

DATË/A:	04.03.2022
REFERENC/Ë:	04-132 /22
PËR/ZA/TO:	z.Faton Peci, Ministër i MBPZHR-së
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Blerim Hasani, Sekretar i Përgjithshem i MBPZHR-së
NGA/OD/FROM	Isuf Cikaqi, Drejtor i Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregjeve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Programi për Pagesat Direkte për vitin 2022

I nderuar Z. Minister,

Në kornizën e zbatimit të politikave dhe strategjisë për bujqësi dhe zhvillim rural të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe rural për periudhën 2022-2028, dhe bazuar në Ligjin Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe Ligjin Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve ka përgatitë: Programin për Pagesat Direkte për vitin 2022, në kuadër të të cilit janë përcaktuar dhe adresuar objektivat strategjike të zhvillimit të bujqësisë:

- Rritja e konkurrueshmëris të prodhimit primar bujqësor;
- Rritja e të hyrave në fermë;
- Rritja e rendimentit;
- Zvogëlimi i importit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Rritja e kapaciteteve përpunuese;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.


Në kuadër të Programit për Pagesat Direkte për vitin 2022, prioritet i veçantë iu është dhënë sektorëve dhe nënsektorëve të paraqitur në tabelen e më poshtme si dhe aplikimit të përkrahjes shtesë përmes subvencionimit të pjesëshëm të çmimit të naftës dhe subvencionimit të pjesëshëm të sasisë së plehut artificial të shpenzuar/përdorur, vetëm për vitin 2022:

*Programi për pagesat direkte për vitin 2022*

Nr	Sektorët dhe nënsektorët që do të mbështeten përmes programit të pagesave direkte	Vlera e mjeteve përkrahëse për njësi (€)	Përkrahje shtesë/e veçant përmes subvencionimit të pjesëshëm të çmimit të naftës, në vlerë prej 0.36 €/liter	Përkrahje shtesë/e veçant përmes subvencionimit të pjesëshëm të sasisë së plehut artificial të shpenzuar/përdorur, në vlerë prej 100 ose 150 €/ha
1	Pagesat direkte për sipërfaqet e mbjellura të grurit dhe sasin e dorzuar të grurit	150 €/ha 0.03 €/kg	0.36 €/liter	150 €/ha
2	Pagesat direkte për sipërfaqet e mbjellura të farës së grurit	250 €/ha	0.36 €/liter	
3	Pagesat direkte për sipërfaqet e mbjellura të elbit	150 €/ha	0.36 €/liter	
4	Pagesat direkte për sipërfaqet e mbjellura të thekrës	150 €/ha	0.36 €/liter	
5	Pagesat direkte për sipërfaqet e mbjellura të tërshërës	150 €/ha	0.36 €/liter	
6	Pagesat direkte për sipërfaqet e mbjellura të misrit	175 €/ha	0.36 €/liter	100 €/ha
7	Pagesat direkte për sipërfaqet e mbjellura të lulediellit	170 €/ha	0.36 €/liter	
8	Pagesa direkte për vreshtat ekzistues	1000 €/ha)	0.36 €/liter	
9	Pagesa direkte për verë të prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht	0.04 €/liter	0.36 €/liter	
10	Pagesa direkte për pemishtet ekzistuese	450 €/ha	0.36 €/liter	
11	Pagesa direkte për sasin e dorzuar/shitur te frutave të mjedrës	0.15 €/kg	0.36 €/liter	
12	Pagesa direkte për prodhimtarinë e materialit fidanor të pemëve drufrutore	0.25 dhe 0.20 €/copë të fidanit (Sipas mënyrës së përshkallëzimit)		
13	Pagesa direkte për prodhimtarinë e materialit fidanor të hardhisë së rrushit	0.15 €/ copë të fidanit		
14	Pagesat direkte për sipërfaqet e mbjellura me perime	Perimet në fushë të hapur 500 €/ha Perimet në serra 850 €/ha Kunguj dhe kunguj misirit 150 €/ha	0.36 €/liter	100 €/ha (vetëm për patate dhe fasule monokulturë)

15	Pagesa direkte për bimët mjekësore dhe aromatike / BMA	450 €/ha	0.36 €/liter	
16	Pagesa direkte për bujqësi organike	50 €/ha	0.36 €/liter	
17	Pagesa direkte për primin e sigurimit bujqësor për kulturen bujqësore të mjedres, molles, kumbulles, rrushit, dredhëzes, specit, arrës, fasulës, misrit, qershisë, vishnjës dhe dardhës	75 % e primit të sigurimit		
18	Pagesa direkte për lopë dhe buallica qumështore	90 €/krer		
19	Pagesa direkte për dele	25 €/krer		
20	Pagesa direkte për dhi	25 €/krer		
21	Pagesa direkte për bletë	20 €/krer		
22	Pagesa direkte për qumështin sipas kategorive të cilësisë	Klasa extra = 0.07 €/liter Klasa I = 0.04 €/liter Klasa II = 0.02 €/liter		
23	Pagesa direkte për pulat vojse	0.50 dhe 0.40 €/pulë vojse (Sipas mënyrës së përshkallëzimit)		
24	Pagesa direkte për dosa në riprodhim	25 €/krer		
25	Pagesa direkte për therjet e raportuara të gjedhit	50 €/krer të therur		
26	Pagesa direkte për akuakulturë	0.20 €/kg		
27	Pagesa direkte për viqat për majmëri	25 €/krer		

Aprovoi:



Faton Peci, Ministër i Bujqësisë,  
Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

04.03.2022

Data

**PAGESAT DIREKTE PËR: GRURË, FARË TË GRURIT, ELB, THEKËR, TËRSHËR, MISËR, LULEDIELLI, PERIME, PEMISHTË EKZISTUESE, VRESHTA EKZISTUESE, VERË E PRODHUAR DHE E DEKLARUAR ZYRTARISHT, MATERIAL FIDANOR TË PEMËVE DRUFRUTORE DHE HARDHISË SË RRUSHIT, BIMË MJEKSORE AROMATIKE, PRODHIMTARI ORGANIKE DHE SIGURIMET BUJQESORE**

**1. LEGJISLACIONI REFERUES:**

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27.07.2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16.10.2012);
- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25.03.2009);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12.01.2009);
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16.10.2012);
- Ligji Nr. 2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/15.12.2006);
- Ligji Nr. 02/L-8 për Verërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9,/01.02.2007);
- Ligji Nr. 04/L-019 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-8 për Verërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 13/01.09.2011);
- Ligji Nr. 2004/13 për Materialin Fidanor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22,/ 01.03.2008);
- Ligji Nr 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 01/ 17.01.2013);
- Ligji Nr.05/L-031 për Procedurat e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr.20/21.06.2016);
- Ligji Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 ( Gazeta Zyrtare Nr.13/31.12.2021);
- Ligji Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës (Gazeta Zyrtare Nr. 14 /17 Korrik 2019);
- Ligji Nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Gazeta Zyrtare: 16/26 Qershor 2015);
- Ligji Nr. 03/L-212 i Punës ( Gazeta Zyrtare /Nr. 90/1 dhjetor 2010);
- Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë;
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2022.

**PAGESAT DIREKTE PËR SIPËRFAQET E MBJELLA ME GRUR DHE SASIN E DOREZUAR TË GRURIT**

**1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT TË DRITHËRAVE / GRURIT:**

Sektori i drithërave është me rëndësi strategjike dhe ekonomike për vendin, duke u bazuar në resurse natyrore dhe numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar në këtë sektor. Rëndësia e

këtij sektori qëndron edhe në ndikimin që ka në zhvillimin e sektorëve të tjerë, si të blegtorisë dhe agro-përpunimit.

Në Kosovë, për vite me radhë mesatarisht mbillen prej 65,000 deri 80,000 hektarësh me grurë. Rendimentet mesatare të arritura nëpër vite sillen rreth 4 t/h, varësisht nga kushtet agroklimatike dhe prodhuese të vendit tonë, si dhe masat e ndërmarra agroteknike nga ana e fermerëve. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet të vazhdohet edhe më tutje me mbështetje përmes pagesave direkte. Kjo mënyrë e mbështetjes do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes kësaj mbështetjeje të sektorit me synohet të arrihet rritja e prodhimtarisë së grurit. Aktualisht Kosova i plotëson nevojat e veta rreth 70-80% të konsumit me grurë.

## **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve vjeshtore (grurit) do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, rritja e çmimit të inputeve bujqësore si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyet e përkrahjes së sektorit, duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët punojnë në këtë sektor, si dhe duke pasur parasysh resurset natyrore të vendit.

## **3. QËLLIMI I PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë drithëra/grurë.

### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë .

### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;

## **4. PËRFITUESIT:**

### **4.1. Fermerët që kultivojnë drithëra/grurë:**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kultivojnë grur dhe fermeret të cilë kultivojnë grur dhe sasin e prodhuar të grurit e dorzojnë në pikat grumbulluese (mulli, sillos ose pikë të veçant grumbulluese të grurit), dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

## **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellur së paku 2 ha me grur;
- Parcela e mbjellë me grurë duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë;
- Të dorëzojnë së paku 6000 kg grurë në pikat grumbulluese, të cilat duhet të jenë të regjistruara si biznese (mulli, sillos ose pikë të veçantë grumbulluese të grurit);
- Të deklarojnë nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.

## **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirlogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për dorëzimin e sasisë së grurit në pikën grumbulluese (mulli, sillos ose pikë të veçantë grumbulluese të grurit). Në dëshminë e leshuar nga pika grumbulluese përkatëse, për sasinë e grurit që fermeri ka dorëzuar, duhet të jetë i shënuar edhe numri identifikues i fermerit (NIF), si dhe dëshmia duhet të jetë e nënshkruar dhe vëlosur nga ana e personit të autorizuar të pikës grumbulluese. (Ky dokument duhet të sillej/dorëzohet mbas realizimit/përfundimit të procesit të korrje shirjes së grurit).
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit;

## **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe-hektar ose për sipërfaqe-hektar dhe sasi- kg të grurit të dorëzuar:
  - a) Subvencionimi për sipërfaqe/ha, në vlerë prej 150 €/ha, dhe
  - b) Subvencionimi për sasi- kg të grurit të dorëzuar, në vlerë prej 0.03 €/kg;
- Subvencionimi do të ju jepet fermerëve të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë grurë me sipërfaqe së paku 2 ha ose fermerëve të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë grurë me sipërfaqe së paku 2 ha dhe që kanë dorëzuar së paku 6000 kg grurë në pikën grumbulluese (mulli, sillos ose pikë të veçantë grumbulluese të grurit), dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

## **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë/kultivuar ose numrit të hektarëve të mbjellë/kultivuar dhe sasisë së dorzuar të grurit, të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

## **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjas 30 nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

## **10. ZBATIMI I PROGRAMIT:**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **PAGESAT DIREKTE PËR SIPËRFAQET E MBJELLURA TË FARËS SË GRURIT**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT TË DRITHËRAVE / FARËS SË GRURIT:**

Kosova aktualisht i plotëson nevojat me farë gruri rreth 10-15%. Për shkak të kostos së lartë të prodhimit, një pjesë e fermerëve e shfrytëzojnë farën vetanake për mbjelljen e grurit (rreth 20 - 25 % e tyre).

Procesi i prodhimit të farës së grurit është një veprimtari ekonomikisht e kushtueshme, duke i marrë për bazë fazat e prodhimit si: sigurimi i farës cilësore, shumëzimi, para kultura, inspektimet fushore, përpunimi, etiketimi, mostrimi i farës si dhe masat shtesë të mbrojtjes. Mbështetja e prodhuesve të farës së grurit do të ndikojë në uljen e kostos së prodhimit të farës. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet sigurimi i farës së grurit brenda vendit, me qëllim të rritjes së rendimentit dhe përmirësimit të cilësisë së grurit të prodhuar.

### **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve vjeshtore (farë gruri) do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, rritja e çmimit të inputeve bujqësore si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë kërkesat e tregut dhe resurset natyrore të vendit.

### **3. QËLLIMI I PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve prodhues të farës së grurit.

#### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

### 3.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit të grurit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit të farës së grurit dhe grurit merkantil;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Rritja e kapaciteteve përpunuese;

### 4. PËRFITUESIT:

#### 4.1. Fermerët që kultivojnë farë të grurit:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kultivojnë farë të grurit dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### 4.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

### 5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 5 ha me grurë për prodhimin e farës;
- Të posedojnë kontratë me kompaninë prodhuese të farës;
- Parcela e mbjellë me grurë për farë duhet të jetë së paku 1 ha e pandarë;
- Fara e mbjellur e varietetit të grurit duhet të jetë në Listën e Farërave të Kosovë;
- Të deklarojnë nën betim, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit;

Tab. 1. VARIETETET E GRURIT NË LISTEN E FARËRAVE NË KOSOVË

Nr	EMRI I VARIETETIT TË GRURIT	Data e regjistrimit	Data e skadimit të regjistrimit
1	NIKOL	19.09.2012	19.09.2022
2	ANDINO	19.09.2012	19.09.2022
3	BALATON	19.09.2012	19.09.2022
4	BC PRIMA	19.09.2012	19.09.2022
5	SIRTAKI	19.09.2012	19.09.2022
6	EUCLIDE	19.09.2012	19.09.2022
7	Kg 56-S	02.10.2013	02.10.2023
8	VIZIJA	02.10.2013	02.10.2023
9	KRISTINA	02.10.2013	02.10.2023
10	PLANETA	02.10.2013	02.10.2023
11	ESPERIA	02.10.2013	02.10.2023
12	VITTORIO	02.10.2013	02.10.2023
13	STENDAL	02.10.2013	02.10.2023
14	ZANZIBAR	02.10.2013	02.10.2023
15	SIMONIDA	02.10.2013	02.10.2023
16	ZVEZDANA	02.10.2013	02.10.2023
17	VULKAN	02.10.2013	02.10.2023
18	ALTEZZA	18.12.2014	18.12.2024
19	ADELAIDE	18.12.2014	18.12.2024
20	ANTILLE	18.12.2014	18.12.2024



21	LUCIJA	18.12.2014	18.12.2024
22	KATARINA	18.12.2014	18.12.2024
23	KRALJICA	18.12.2014	18.12.2024
24	Bc ANICA	14.10.2016	14.10.2026
25	SOSTHENE	14.10.2016	14.10.2026
26	DARDANIA-1	13.12.2016	13.12.2026
27	ZEMUNSKA ROSA	27.10.2017	24.10.2027
28	AURELIA	27.10.2017	27.10.2027
29	FARINELLI	27.10.2017	27.10.2027
30	ORCAS	27.10.2017	27.10.2027
31	CELLULE	27.10.2017	27.10.2027
32	NOGAL	27.10.2017	27.10.2027
33	ANDALUSIA	27.10.2017	27.10.2027
34	BISANZIO	27.10.2017	27.10.2027
35	EVROPA 90	30.10.2018	30.10.2028
36	POBEDA	30.10.2018	30.10.2028
37	RENEZANSA	30.10.2018	30.10.2028
38	SOBRED	30.10.2018	30.10.2028
39	SOLVEIG	30.10.2018	30.10.2028
40	ANAPURNA	30.10.2018	30.10.2028
41	FARMEUR	30.10.2018	30.10.2028
42	SOTHYS SC	30.10.2018	30.10.2028
43	MV SUBA	19.09.2019	19.09.2029
44	MV TOBORZO	19.09.2019	19.09.2029
45	ATHLON	26.09.2019	26.09.2029
46	NS MILA	26.09.2019	26.09.2029
47	NS ILINA	26.09.2019	26.09.2029
48	Bc DARIJA	26.09.2019	26.09.2029
49	TIKA TAKA	26.09.2019	26.09.2029
50	MV IKVA	26.09.2019	26.09.2029
51	MV NADOR	26.09.2019	26.09.2029
52	MV NEMERE	26.09.2019	26.09.2029
53	BASILIO	23.09.2020	23.09.2030
54	SOLINDO CS	23.09.2020	23.09.2030
55	BC OPSESIJA	27.09.2021	27.09.2031
56	BC LJEPOTICA	27.09.2021	27.09.2031
57	FRENETIC	27.09.2021	27.09.2031
58	AVENUE	27.09.2021	27.09.2031
59	ZP OSATKA	27.09.2021	27.09.2031
60	COMPLICE	27.09.2021	27.09.2031
61	GALLOPER	27.09.2021	27.09.2031
62	EL NINO	27.09.2021	27.09.2031
63	MAKEDONSKA RANA	27.09.2021	27.09.2031
Varetete standarde(krahasues): Mv Suba, Farinelli dhe Altezza			

## **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirrollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Kontratën me kompaninë prodhuese të farës, të vertetuar nga noteri;
- Dëshmi për sasinë e dorëzuar të grurit në kompaninë prodhuese të farës (ky dokument duhet të dorëzohet pas realizimit të procesit të korrje-shirjeve të grurit për prodhimin e farës);
- Dëshmi mbi kategorinë e farës së grurit të mbjellë;
- Formulari për sipërfaqet e mbjella me grurë për prodhimin e farës, të verifikuar nga MBPZHR-ja;
- Raporti i Inspektoratit fito sanitar - AUV nga inspektimet fushore I dhe II (ky dokument duhet të dorëzohet pasi të realizohen inspektimet fushore);
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.

## **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe/ha, në vlerë prej 250 €/ha. Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë grurë për prodhimin e farës me sipërfaqe së paku 5 ha dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.
- Pas realizimit të dy inspektimeve fushore nga ana e inspektorëve fito sanitarë -AUV, nëse parcelat i plotësojnë kriteret për prodhim të farës së grurit, atëherë subvencionimi do të bëhet në vlerë prej 250 €/ha. Ndërsa, nëse parcelat nuk i plotësojnë kriteret për prodhim të farës së grurit dhe refuzohen, atëherë fermerët do të përfitojnë vetëm subvencionin për prodhimtarinë e grurit merkantil në vlerë prej 150 €/ha.

## **8. MËNYRA E IMPLEMENTIMIT:**

Pas verifikimit të dokumentacionit, realizohen dy inspektime në terren nga ana e inspektorëve fito sanitarë - AUV. Inspektimi i parë realizohet pas ngallimit të grurit, ndërsa inspektimi i dytë realizohet pas dy javëve, të sipërfaqet e mbjella me grurë për farë (Përgjegjës për inspektim është Inspektorati fito sanitar AUV), dhe në fund bëhet lëshimi i raportit për sipërfaqet e grurit për farë, të pranuar dhe ato të refuzuara.

## **9. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas përfundimit të inspektimeve dhe hartimit të listave përfundimtare të përfituesve, dhe kompletimit të dokumentacionit bëhet pagesa e fermerëve përfitues vetëm për sipërfaqet e pranuar për farë të grurit dhe dëshmisë mbi sasinë e dorëzuar të grurit për prodhimin e farës,

bazuar në rendimentin mesatar të grurit për vitin aktual. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

## **10. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatës për Bujqësi.

## **11. ZBATIMI I PROGRAMIT:**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **PAGESAT DIREKTE PËR SIPËRFAQET E MBJELLURA TË ELBIT**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT TË DRITHËRAVE / ELBIT:**

Elbi është produkt i rëndësishëm në prodhimtarinë e birrës dhe ushqimin e kafshëve. Në Kosovë, mesatarisht mbillen rreth 2,000 ha me elb, rendimenti mesatar ndër vite sillet rreth 3 t/ha, varësisht nga kushtet agroklimatike të vendit tonë, si dhe masat e ndërmarra agroteknike. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet mbështetje direkte përmes subvencionimit. Kjo mënyrë e mbështetjes do të ndikojë drejtpërdrejtë në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes mbështetjes së sektorit me pagesa direkte, synohet të rritet prodhimtaria e elbit.

### **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve me elb do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi i ushqimit për kafshë, përdorimi si produkt i rëndësishëm në prodhimtarinë e birrës si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të vendit.

### **3. QËLLIMI PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë drithëra/elb.

#### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

#### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;

#### **4. PËRFITUESIT:**

##### **4.1. Fermerët që kultivojnë drithëra/elb:**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë elb dhe i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

##### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

#### **5. KRITERET OË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **1 ha** me elb;
- Parcela e mbjellë me elb duhet të jetë së paku **0.20 ha** e pandarë;
- Të deklarojnë nën betim, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojn në momentin e aplikimit;

#### **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojn në momentin e aplikimit.

#### **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe - ha, në vlerë prej **150 €/ha**.
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë elb me sipërfaqe së paku **1 ha** dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

#### **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë **30 ditë** nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

## **10. ZBATIMI I PROGRAMIT**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

### **PAGESAT DIREKTE PËR SIPËRFAQET E MBJELLURA TË THEKRËS**

#### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT TË DRITHËRAVE / THEKRËS:**

Në Kosovë, mesatarisht mbillen rreth 400 hektarë me thekër. Rendimenti mesatare ndër vite sillet rreth 2.5 t/ha, varësisht nga kushtet agroklmatike të vendit tonë, si dhe masat e ndërmarra agroteknike.

Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet mbështetje direkte përmes pagesave direkte - subvencionimit. Kjo mënyrë e mbështetjes do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes mbështetjes të sektorit me pagesa direkte, synohet të rrite prodhimtaria e thekrës.

#### **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritje të konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve me thekër do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, sigurimi i ushqimit për kafshë, përdorimi në industrinë e ushqimit, rritja e çmimit të inputeve bujqësore si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të vendit.

#### **3. QËLLIMI PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë drithëra/thekër.

##### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

##### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;

#### **4. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:**

##### **4.1. Fermerët që kultivojnë drithëra / thekër:**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë thekër dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

#### **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **1 ha** me thekër;
- Parcela e mbjellë me thekër duhet të jetë së paku **0.20 ha** e pandarë;
- Të deklarojnë nën betim, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit;

#### **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit -ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshminë për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.

#### **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe-hektar në vlerë prej **150 €/ha**.
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë thekër me sipërfaqe së paku **1 ha** dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

#### **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë **30 ditë** nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale përkatëse për Bujqësi.

#### **10. ZBATIMI I PROGRAMIT:**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **PAGESAT DIREKTE PËR SIPËRFAQET E MBJELLURA TË TËRSHËRES**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT TË DRITHËRAVE / TËRSHËRES:**

Në Kosovë, mesatarisht mbillen rreth 2000 - 2500 hektarë me tërshër. Rendimenti mesatare ndër vite sillet rreth 2.0 deri 2.5 t/ha, varësisht nga kushtet agroklimatike të vendit tonë, si dhe masat e ndërmarra agroteknike.

Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet mbështetje direkte përmes pagesave direkte - subvencionimit. Kjo mënyrë e mbështetjes do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes mbështetjes të sektorit me pagesa direkte, synohet të rrite prodhimtaria e tërshëres.

### **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritje të konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve me tërshër do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi i ushqimit për kafshë, përdorimi në industrinë e ushqimit, rritja e çmimit të inputeve bujqësore si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të vendit.

### **3. QËLLIMI PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë drithëra/tërshër.

#### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

#### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;

### **4. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:**

#### **4.1. Fermerët që kultivojnë drithëra / tërshër:**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellur/kultivojnë tërshër dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

### **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

- Të kenë të mbjellë së paku 1 ha me tërshër;
- Parcela e mbjellë me thekër duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë;
- Të deklarojnë nën betim, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojn në momentin e aplikimit;

## **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshminë për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqës për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojn në momentin e aplikimit.

## **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe-hektar në vlerë prej 150 €/ha.
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë tërshër me sipërfaqe së paku 1 ha dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

## **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

## **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

## **10. ZBATIMI I PROGRAMIT**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **PAGESAT DIREKTE PËR SIPËRFAQET E MBJELLURA TË MISRIT**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT TË DRITHËRAVE / MISRIT:**

Në Kosovë, për vite me radhë mesatarisht mbillen prej 35,000 – 50,000 ha me misër. Dominon kultivimi i misrit kokërr edhe pse në vitet e fundit kemi një ndryshim të strukturës në favor të rritjes së sipërfaqeve të mbjella me misër foragjer.



Rendimenti mesatar i misrit nëpër vite sillet nga 3.5 deri në 4.5 t/ha, varësisht nga kushtet agroklimatike të vendit tonë, si dhe masat e ndërmarrja agroteknike. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet të vazhdohet edhe më tutje përmes mbështetjes direkte. Kjo masë mbështetëse do të ndikojë drejtpërdrejtë në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet sigurimi i vetëmjaftueshmërisë me ushqim të koncentruar për kafshë (misër). Kjo mbështetje do të ketë ndikim edhe në uljen e kostos së prodhimeve blegtorale dhe përmirësimin e cilësisë.

## **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve pranverore (misër) do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, sigurimi i ushqimit për kafshë, rritja e çmimit të inputeve bujqësore si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i ka vendi.

## **3. QËLLIMI PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë misër.

### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimeve;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Shfrytëzimi i kapaciteteve përpunuese të ushqimit të kafshëve;

## **4. PËRFITUESIT:**

### **4.1. Fermerët që kultivojnë misër:**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë misër dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

## **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 1 ha me misër;
- Parcela e mbjellë me misër duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë;

- Të deklarojn nën betim, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojn në momentin e aplikimit;

## **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojn në momentin e aplikimit.

## **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe-hektar, në vlerë prej 175 €/ha.
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë misër me sipërfaqe së paku 1 ha dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

## **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

## **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

## **10. ZBATIMI I PROGRAMIT**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **PAGESAT DIREKTE PËR SIPËRFAQET E MBJELLURA TË LULEDIELLIT**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT TË DRITHËRAVE / LULEDIELLIT:**

Luledielli është kulturë industriale dhe luan rol të rëndësishëm në industrinë ushqimore dhe atë përpunuese. Përdoret si lëndë e parë në industrinë e vajit, ushqim për kafshët (bimë e gjelbër, e silazhuar) si dhe mbetje të përpunimit industrial (bërsi). Në vitet e '80-'90-ta kjo kulturë është kultivuar në sipërfaqe të mëdha në tokat bujqësore të Kosovës, duke arritur në rreth 200 hektarë, me rendiment mesatar rreth 2000 kg për hektar.

Në Kosovë, për vite me radhë nuk është kultivuar luledielli, por në vitet e fundit ka filluar të shfaqet interesimi për kultivimin e kësaj kulture vajore -industriale. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet të vazhdohet edhe më tutje mbështetja direkte përmes subvencionimit. Kjo mbështetje do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit.

Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet sigurimi i lëndës së parë për prodhimin e vajit dhe ushqimit të koncentruar për bagëti. Ky veprim do të ketë efekt edhe në uljen e kostos së prodhimeve blegtorale dhe përmirësimin e cilësisë.

## **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve pranverore (luledielli) do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, rritja e çmimit të inputeve bujqësore si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë parasysh interesin për zhvillimin e kësaj kulture bujqësore dhe resurset natyrore të vendit.

## **3. OËLLIMI I PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë luledielli.

### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Shfrytëzimi i kapaciteteve përpunuese të ushqimit të kafshëve;

## **4. PËRFITUESIT:**

### **4.1. Fermerët që kultivojnë luledielli:**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë luledielli dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

## **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 1 ha me luledielli;
- Parcela e mbjellë me luledielli, duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë;

- Të deklarojnë nën betim, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit;

## **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.

## **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe-hektar, në vlerë prej 170 €/ha.
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë luledielli së paku 1 ha dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

## **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

## **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

## **10. ZBATIMI I PROGRAMIT:**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **PAGESAT DIREKTE PËR SIPËRFAQET E MBJELLURA ME PERIME**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - RENDESIA E PERIMEVE:**

Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbjellë me perime në Kosovë është rreth 19,243 ha hektarë apo 332 ha më shumë se në vitin 2019. Kulturat perimore të cilat kultivohen në sipërfaqe më të mëdha janë: speci, domatja, qepa, shalqiri, lakra etj.

Kultivimi i perimeve është i përqendruar kryesisht në luginën e Anadrinit, në trekëndëshin që ndodhet në fushën e Dukagjinit në mes të Rahovecit, Gjakovës dhe Prizrenit si dhe në

Anamoravë. Rreth 3,134 hektarë me specia kultivohen në këtë pjesë. Shalqiri është kultura tjetër me rëndësi, përderisa prodhimi i domateve ka një rritje të sipërfaqeve të kultivuara si në fushë të hapur e po ashtu edhe në ambiente të mbrojtura (serra).

## **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e sektorit të perimeve do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, rritja e të ardhurave të fermerëve si dhe rritjet e çmimit të inputeve bujqësore janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të vendit.

## **3. QËLLIMI I PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë perime.

### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;

## **4. PËRFITUESIT:**

### **4.1. Fermerët që kultivojnë perime:**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë perime dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

## **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 0.30 ha me perime në fushë të hapur ose 0.10 ha me perime në serra ose së paku 0.30 ha me perime në fushë të hapur dhe në serrë së bashku;
- Parcela e mbjellë me perime në fushë të hapur duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë;
- Parcela e mbjellë me perime në ambiente të mbrojtura (serra) duhet të jetë së paku 0.05 ha e pandarë;
- Fermerët/aplikuesit që kultivojnë dhe aplikojnë për kulturën perimore kungull, të kenë kontratë të vertetuar nga noteri për shitjen e kungullit me ndonjëren nga kompanit që realizojnë grumbullimin dhe përpunimin e kungullit (vlen vetëm për fermerët që kultivojnë kungull me sipërfaqe mbi 2 ha);

- Fermerët/aplikuesit që kultivojnë dhe aplikojnë për kulturën perimore kungull, të kenë dëshmi për sasinë e kungujve të shitur në ndonjërin nga kompanit që realizojnë grumbullimin dhe përpunimin e kungullit (vlen vetëm për fermeret që kultivojnë kungull me sipërfaqe mbi 2 ha);
- Fermerët/aplikuesit që kultivojnë dhe aplikojnë për kulturën perimore kungull, të kenë dëshminë e pagesës nga banka për sasinë e kungujve të shitur (vlen vetëm për fermeret që kultivojnë kungull me sipërfaqe mbi 2 ha).
- Fermerët/aplikuesit që kultivojnë dhe aplikojnë për kulturën perimore kungull, të shesin së paku 5000 kg kunguj në kompanit që realizojnë grumbullimin dhe përpunimin e kungullit (vlen vetëm për fermeret që kultivojnë kungull me sipërfaqe mbi 2 ha).
- Të deklarojnë nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit;

## **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirrologarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Kontrata e vërtetuar nga noteri me ndonjërin nga kompanit që realizojnë grumbullimin dhe përpunimin e kungullit (vlen vetëm për fermeret që kultivojnë kungull me sipërfaqe mbi 2 ha);
- Dëshmi për sasinë e kungujve të shitur në ndonjërin nga kompanit që realizojnë grumbullimin dhe përpunimin e kungullit. (Ky dokument duhet të silllet-dorëzohet pas përfundimit të sezonit të vjelës dhe shitjes të kungujve dhe vlen vetëm për fermeret që kultivojnë kungull me sipërfaqe mbi 2 ha);
- Dëshmi e pagesës nga banka për sasinë e kungujve të shitur. (Ky dokument duhet të silllet-dorëzohet pas përfundimit të sezonit të vjelës dhe shitjes të kungujve dhe vlen vetëm për fermeret që kultivojnë kungull me sipërfaqe mbi 2 ha).
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.

## **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe-hektarë të mbjellur/kultivuar me perime:
  - a) Subvencionimi në vlerë prej 500 €/ha për perimet e mbjellura/kultivuara në fushë të hapur, përjashtimisht kulturës perimore kunguj dhe kunguj të misirit;
  - b) Subvencionimi në vlerë prej 850 €/ha për perimet e mbjellura/kultivuara në serra;
  - c) Subvencionimi në vlerë prej 150 €/ha, për kulturën perimore kunguj dhe kunguj të misirit;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë perime, me sipërfaqe së paku 0.30 ha me perime në fushë të hapur ose 0.10 ha me perime në serra ose së paku 0.30 ha

me perime në fushë të hapur dhe në serrë së bashku dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

#### **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

#### **10. ZBATIMI I PROGRAMIT:**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

*Tab. 2. Kulturat perimore që do të mbështeten përmes programit të pagesave direkte*

Nr	Emri i kulturës perimore
1	Patatja
2	Domatja
3	Patëllxhani zi
4	Speci
5	Kungulli
6	Kungulli i Misirit
7	Kungullesha
8	Trangulli
9	Shalqiri
10	Pjepri
11	Lakra
12	Lulelakra
13	Spinaqi
14	Sallata (të gjitha varietetet)
15	Pangjari (te gjitha varietetet)
16	Majdanozi
17	Preshi
18	Qepa
19	Rrepka
20	Hudhra
21	Fasulja monokulturë
22	Karrota
23	Asparagu
24	Brokoli

**Sqarim:** në sipërfaqen e njejtë të tokës bujqësore në fushë të hapur ose në të njejtën sipërfaqe të serrës, brenda një viti, fermeri/aplikuesi mund të kultivojë disa here perime të llojeve të ndryshme, mirëpo subvencionimin do ta marrë vetëm një (1) herë brenda vitit për të njejtën sipërfaqe të mbjellur me perime. Pra nuk mund të marrë subvencion, për sipërfaqen e njejtë, më shumë se një herë brenda një viti.

## **PAGESAT DIREKTE PËR VRESHTAT EKZISTUESE**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - RËNDËSIA E VRESHTARISË:**

Sektori i vreshtarisë është me rëndësi strategjike dhe ekonomike për vendin, duke u bazuar në resurse natyrore dhe në numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar në këtë sektor. Rëndësia e këtij sektori qëndron edhe në ndikimin që ka në zhvillimin e sektorëve të tjerë, si në sektorin e verërave dhe agro-përpunimit.

Sipas të dhënave nga kadastra e vreshtave në Kosovë aktualisht janë rreth 3,437 ha me vreshta dhe më shumë se 4500 fermerë që merren direkt me kultivimin e vreshtit.

Në vitet e fundit kemi një zhvillim më intensiv të sektorit, janë bërë investime të rëndësishme në sektorin e vreshtave dhe verërave. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet vazhdimi i mbështetjes direkte përmes subvencionimit. Kjo mbështetje do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit.

Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet mirëmbajtje e vazhdueshme e sipërfaqeve aktuale dhe shtimi i sipërfaqeve të reja me vreshta.

### **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mirëmbajtjes së sipërfaqeve më vreshta do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, rritja e të ardhurave të fermerëve si dhe rritjet e çmimit të inputeve bujqësore, ruajtja dhe zgjerimi i sipërfaqeve me vreshta, ndalimi i imigrimit nga zonat rurale në zonat urbane janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, si dhe duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të vendit.

### **3. QËLLIMI PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë vreshta (rrush).

#### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e vreshtave ekzistuese;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

#### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e rendimentit;



- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;

#### **4. PËRFITUESIT:**

##### **4.1. Fermerët që kultivojnë vreshta (rrush):**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë vreshta (rrush) dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

##### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

#### **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 0.10 ha me vreshta;
- Parcela e mbjellë me vreshta duhet të jetë së paku 0.05 ha e pandarë;
- Të jenë të rexhistruar në kadastrin e vreshtave në DVV - MBPZHR;
- Vreshti duhet të jetë i mirëmbajtur (i lëvruar në mes të rreshtave ose me bari të kultivuar në mes të rreshtave, krasitur, mbrojtur nga sëmundjet dhe dëmtuesit) dhe sistemi i mbjelljes të jetë me renditje të qartë dhe të rregullt të rendeve/rreshtave.
- Të deklarojnë nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit;

#### **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi nga kadastrin e vreshtave mbi sipërfaqen e vreshtit - certifikata origjinale e vreshtit e leshuar nga Departamenti i Vreshtarisë dhe Verërave – MBPZHR;
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.

#### **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe-hektarë, në vlerë prej 1000 €/ha;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë së paku 0.10 ha vreshtë dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi;

## **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve, bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesa bëhen në xhiorollogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

## **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

## **10. ZBATIMI I PROGRAMIT**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **PAGESAT DIREKTE PËR VERËN E PRODHUAR DHE TË DEKLARUAR ZYRTARISHT**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - RËNDËSIA E VERËTARISË:**

Sektori i verëtarisë është me rëndësi ekonomike për vendin, duke u bazuar në resurset natyrore dhe numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar. Rëndësia e tij qëndron edhe në ndikimin që ka në zhvillimin e sektorëve të tjerë dhe në aspektin socio – ekonomik për rajonet vreshtare. Në vitet e 80-a Kosova kishte eksport mbi 30 milion litra verë e cila kryesisht eksportohej në Gjermani. Sipas të dhënave nga kadastra i vreshtave aktualisht janë 3,437 ha me vreshta dhe më shumë se 4500 fermer që merren direkt me kultivimin e vreshtit.

Në vitet e fundit kemi një zhvillim më intensiv të sektorit, ku janë bërë investime të rëndësishme në sektorin e verërave. Kompanitë prodhuese të verërave dhe prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera të licencuara nga MBPZHR, kanë bërë investime të konsiderueshme që nga linjat e pranimit e deri te mbushtoret më moderne. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të verëtarisë, kërkohet vazhdimi i mbështetjes përmes subvencionimit. Kjo masë mbështetëse do të ndikoj drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë, mirëmbajtjen e verës, deklarin zyrtar dhe rritjen e eksportit të verës.

### **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Strategjisë për Vreshtari dhe Verëtari 2016–2021 parasheh përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte për verën e prodhuar dhe të deklaruar zyrtarisht në Departamentin për Vreshtari dhe Verëtari, do të kontribuoj në realizimin e kësaj objektive.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, rritja e të ardhurave për fermerët dhe kompanitë prodhuese si dhe rritjet e çmimit të inputeve bujqësore, janë edhe arsyet e përkrahjes së këtij sektori, pastaj ruajtja dhe zgjerimi i sipërfaqeve me vreshta, modernizimi i kapaciteteve përpunuese, si dhe duke pas parasysh rëndësinë e kësaj industrie.

### **3. QËLLIMI I PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e kompanive prodhuese te verës.

#### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e rentabilitetit të kompanive prodhuese te verës;
- Luftimi i informalitetit dhe rritja e deklarimit zyrtar;
- Rritja e sasisë së verës të prodhuar dhe të deklaruar zyrtarisht me qëllim të ruajtjes së cilësisë dhe krijimin e identitetit për verën Kosovare.

#### **3.2. Objektivat specifike:**

- Përmirësimi i cilësisë së verës se prodhuar;
- Rritja e nivelit të formalizimit dhe deklarimeve zyrtare;
- Vendosja në sistemin zyrtar të kontrollit te prodhimit te verës.

### **4. PËRFITUESIT:**

#### **4.1 Kompanitë prodhuese të verërave të cilat janë të licencuara nga MBPZHR.**

- Përfitues do të jenë kompanitë prodhuese të verërave të cilat janë të licencuara nga MBPZHR, e të cilat i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

### **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË KOMPANITË PRODHUESE TË VERËS:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Aplikuesit/subjektet duhet te jen të licencësuar në MBPZHR për prodhimin e verërave;
- Aplikuesit/subjektet duhet që deri më datë 10 Dhjetor 2021 në Departamentin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë të deklarojnë të dhënat për deklarimin përfundimtar të vjeljes së rrushit për vjeljet e vitit 2021;
- Aplikuesit/subjektet duhet që deri më datë 15 Janar 2022 në Departamentin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë të deklarojnë të dhënat e prodhimit vjetor të verës për vjeljet e vitit 2021.

### **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetem për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm per personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm per personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit te biznesit (vetëm per personat juridik);

## **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për litër verë të prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht, në vlerë prej 0,04 €/litër;

## **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa për litër verë të prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht të verifikuara nga inspektorët e AZHB-së dhe zyrtarët e Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të kompanive prodhuese të verës, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

## **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të kompanive prodhuese të verës për pagesa direkte të verës së prodhuar dhe të deklaruar zyrtarisht zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

## **10. ZBATIMI I PROGRAMIT**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Departamenti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë.

### **PAGESAT DIREKTE PËR PEMISHTET EKZISTUESE**

#### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - RËNDËSIA E PEMËTARISË:**

Sektori i pemëtarisë është me rëndësi strategjike dhe ekonomike për vendin, duke u bazuar në resurse natyrore dhe numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar në këtë sektor. Rëndësia e këtij sektori qëndron edhe në ndikimin që ka në zhvillimin e sektorëve të tjerë, si në sektorin e prodhimit të materialit fidanor dhe agro-përpunimit.

Aktualisht në Kosovë janë të mbjella rreth 10,265 ha, me pemë të të gjitha llojeve. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet mbështetje përmes pagesave direkte. Kjo mbështetje do të ndikojë drejtpërdrejtë në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet mirëmbajtje e vazhdueshme e sipërfaqeve aktuale dhe zgjerimi i sipërfaqeve të reja me pemë.

#### **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e sipërfaqeve të tokës bujqësore të mbjella me pemë do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, rritja e të ardhurave të fermerëve si dhe rritjet e çmimit të inputeve bujqësore janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, ruajtja dhe zgjerimi i sipërfaqeve me pemë, ndalimi i migrimit nga zonat rurale në zonat urbane si dhe duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të vendit.

### **3. QËLLIMI I PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë pemë.

#### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e pemishteve ekzistuese;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

#### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;

### **4. PËRFITUESIT:**

#### **4.1. Fermerët që kultivojnë pemë:**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellur/kultivojnë pemë dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

### **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.50 ha** me pemë drufrutore;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.20 ha** me pemë të imëta (dredhëz, manaferrë, aroni dhe boronicë) në fushë të hapur ose në serrë;
- Parcela e mbjellë me pemë drufrutore duhet të jetë së paku **0.20 ha** e pandarë;
- Parcela e mbjellë me pemë të imëta (dredhëz, manaferrë, aroni dhe boronicë), në fushë të hapur ose në serrë, duhet të jetë së paku **0.10 ha** e pandarë.
- Pemishtja duhet të jetë e mirëmbajtur (e lëvruar ose me bari të kultivuar në mes të rreshtave, krasitur, mbrojtur nga sëmundjet dhe dëmtuesit) dhe sistemi i mbjelljes të jetë me renditje të qartë dhe të rregullt të rendeve/rreshtave;
- Të deklarojnë nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit;

### **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);

- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqës për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.

#### **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe-hektar, në vlerë prej 450 €/ha.
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellur/kultivojnë së paku 0.50 ha me pemë drufutore dhe fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë së paku 0.20 ha me pemë të imëta (dredhëz, manaferrë, aroni dhe boronicë), dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve, bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirrollogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

#### **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjas 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

#### **10. ZBATIMI I PROGRAMIT**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

*Tab. 3. Kulturat pemëtare që do të mbështeten përmes programit të pagesave direkte*

<b>Nr.</b>	<b>Emri i kulturës pemëtare</b>
1	Molla
2	Dardha
3	Ftoni
4	Mushmolla
5	Kumbulla
6	Kajsia
7	Pjeshka
8	Qershia
9	Vishnja
10	Dredhëza
11	Manaferra
12	Aronia
13	Boronica
14	Arra
15	Lajthia

## **PAGESAT DIREKTE PËR SASIN E SHITUR / DORZUAR TE FRUTAVE TE MJEDRES**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT TË PEMËTARISË / MJEDRES:**

Sektori i pemëtarisë e ne veqanti pemët e imta kanë rëndësi strategjike dhe ekonomike për vendin, duke u bazuar në resurse natyrore dhe numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar në këtë sektor. Rëndësia e këtij sektori qëndron edhe në ndikimin që ka në zhvillimin e sektorëve të tjerë, si në sektorin e prodhimit të materialit fidanor dhe sidomos në sektorin e agro-përpunimit.

Aktualisht në Kosovë janë të mbjella rreth 10,265 ha me pemë të të gjitha llojeve, ndersa vetem me kulturen e mjedres janë të mbjellur rreth 1,661 ha, me rendiment mesatar rreth 6000 kg/ha. Prandaj për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm në kultivimin e mjedres, kërkohet mbështetje përmes pagesave direkte. Kjo mbështetje do të ndikojë drejtpërdrejtë në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet mirëmbajtje e vazhdueshme e sipërfaqeve aktuale, zgjerimi i sipërfaqeve të reja me mjeder si dhe rritja e rendimentit për sipërfaqe.

### **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte për sasin e prodhuar-dorzuar të frutave të mjedres do t'i kontribuojë realizimit të këtij objektiv.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, rritja e të ardhurave të fermerëve, ruajtja dhe zgjerimi i sipërfaqeve me mjeder, rritja e rendimentit për sipërfaqe, ndalimi i migrimit nga zonat rurale në zonat urbane si dhe rritja e çmimit të inputeve bujqësore, janë arsytet e përkrahjes së këtij sektori si dhe duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të vendit.

### **3. QËLLIMI I PROGRAMIT:**

- Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë pemë të imta/mjeder.

#### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e pemishteve ekzistuese me mjeder;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

#### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;

### **4. PËRFITUESIT:**

#### **4.1. Fermerët që kultivojnë pemë/mjeder:**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellur/kultivojnë mjeder dhe sasin e prodhuar te frutave të freskët te mjedres e shesin ne pikat grumbulluesese, dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

#### **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 0.10 ha me mjeder, në fushë të hapur ose në serrë;
- Të kenë kontratën për shitjen e frutave te mjedres me ndonjëren nga pikat grumbulluese, te cialt janë të regjistruara si biznese;
- Të shesin së paku 500 kg fruta te mjedres ne pikat grumbulluese;
- Të ofrojë dëshmi bankare për sasinë e frutave te mjedres të shitura;
- Pranojen si të shitura vetem frutat e fresket te mjedres;
- Të deklarojnë nën betim, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojn në momentin e aplikimit;

#### **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetëm per personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm per personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm per personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit te biznesit (vetëm per personat juridik);
- Kontrata e vërtetuar nga noteri me ndonjëren nga kompanit/pikat grumbulluese që realizojn grumbullimin e mjedres;
- Dëshmia për sasinë e frutave te mjedres të shitur në ndonjëren nga pikat grumbulluese. (Ky dokument duhet të sillet/dorëzohet pas perfundimit te sezonës se vjeles se frutave te mjedres dhe shitjes ne pikat grumbulluese, më së largu me 30 nëntor);
- Dëshmia e pagesës nga banka për sasinë e frutave të mjedres të shitur. (Ky dokument duhet të sillet/dorëzohet pas perfundimit te sezonës se vjeles se frutave te mjedres dhe shitjes ne pikat grumbulluese dhe pas realizimit te pagesave per sasin e shitur te frutave te mjedres nga pikat grumbulluese ne xhirollogari te fermerve, më së largu me 15 dhjetor).
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqës për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojn në momentin e aplikimit.

#### **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për kg te shitur te frutave të fresketa te mjedres, në vlerë prej 0.15 €/kg.



- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellur/kultivojnë mjeder me sipërfaqe së paku 0.10 ha dhe që kanë shitur së paku 500 kg fruta të freskëta te mjedres në pikat grumbulluese, dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

## **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve, bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas sasisë së shitur /dorzuar te frutave të freskët te mjedres dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

## **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjas 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

## **10. ZBATIMI I PROGRAMIT**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

**PAGESAT DIREKTE PËR PRIMIN E SIGURIMIT BUJQËSORE INDEKS PËR KULTUREN BUJQËSORE TE MJEDRES, MOLLËS, KUMBULLËS, RRUSHIT, DREDHËZES, SPECIT, ARRËS, FASULËS, MISRIT, QERSHISË, VISHNJËS DHE DARDHËS SI DHE PËR PRIMIN E SIGURIMIT BUJQËSOR TRADICIONAL PËR KULTURËN BUJQËSORE TË MOLLËS - PEMISHTET INTENZIVE, SPECIT - KULTIVIMI INTENZIV DHE RRUSHI I VERËS**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT:**

Prodhimtaria bimore në Kosovë thuhet se çdo vit pëson dëme të konsiderueshme nga fatkeqesit e ndryshme natyrore. Sigurimet bujqësore paraqesin një formë të menaxhimit të rrezikut që shfrytëzohet si mbrojtje nga humbja potenciale duke u ofruar fermerëve mundësinë e mbrojtjes nga rreziqet. Sigurimi bujqësor ofron mbrojtjen nga humbjet dhe dëmet e kulturave ose kafshëve. Përveç kësaj, sigurimi bujqësor paraqet një mjet të rëndësishëm për të zbutur rreziqet dhe për të siguruar rrugë më të sigurt për investimet e bankës.

Sigurimet indeks janë formë e sigurimit bujqësor që kompenzon fermerët për humbjet ose dëmet në bazë të një parametri (indeksi) të paracaktuar si p.sh. reshjet e tepërta të shiut, temperaturat e ulta dhe të larta. Meqë sigurim indeks nuk kërkon domosdoshmërisht shërbimet tradicionale të vlerësuesve të dëmeve, ai lejon që proceset e shlyerjes së dëmeve të jenë më të shpejta, me transparente dhe objektive.

Sigurimi tradicional është formë e sigurimit bujqësor që kompenzon fermerët për humbje ose dëmet për shkak të breshërit apo ndonjë shkaktari tjetër të humbjes ose rreziqeve të parashikuara në polisën e sigurimit. Për dallim nga sigurimi indeks, sigurimi tradicional mbështetet në vlerësimet e dëmit aktual nga vlerësuesit e dëmeve.

## **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e primit të sigurimit bujqësor indeks për kulturen bujqësore të mjedrës, mollës, kumbullës, rrushit, dredhëzes, specit, arrës, fasulës, misrit, qershisë, vishnjës dhe dardhës si dhe primit të sigurimit bujqësor tradicional te kultura mollës - pemishte intenzive, specit - kultivimi intensive dhe rrushit të verës do t'i kontribuoj realizimit të këtij objekti.

Sigurimi i produkteve dhe cilësia e tyre, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyet e përkrahjes së sektorit, duke marr për bazë fatkeqësitë e shpeshta natyrore me të cilat janë përballur fermerët të cilët punojnë në këtë sektor, si dhe duke pasur parasysh resurset natyre të vendit.

## **3. QËLLIMI I PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve për primin e sigurimit bujqësor të cilët kultivojnë mjedër, mollë, kumbull, rrush, dredhëz, spec, arrë, fasulës, misrit, qershisë, vishnjës dhe dardhës si dhe për primin e sigurimit tradicional bujqësor te kultura e mollës - pemishte intenzive, specit - kultivimi intensiv dhe rrushit të verës.

### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave të fermerëve;
- Sigurimi i produkteve të fermerëve;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;
- Mbrojtja nga humbja në rast të dëmeve të shkaktuara;

## **4. PËRFITUESIT:**

- 4.1. Përfituesit do të jenë fermerë që kultivojnë mjedër, mollë, kumbull, rrush, dredhëz, spec, arrë, fasule, misri, qershisë, vishnjës dhe dardhës si dhe primin e sigurimit bujqësor tradicioanel për kulturat bujqësore: mollën, specin, dhe rrushin e verës. dhe të cilët i sigurojnë keto kultura bujqësore tek kompanit e sigurimit dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

- 4.2. Shtirirja gjeografike:
- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT PER PRIMET E SIGURIMIT BUJQESOR INDEKS:

**Kriteret për primet e sigurimit bujqësor indeks:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.20 ha** me mjeder;
- Periudha siguruese për pemishtet me mjeder duhet të jetë prej 1 Korrik 2022 deri 31 Gusht 2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.20 ha** me dredhëz;
- Periudha siguruese për pemishtet me dredhëz duhet të jetë prej 01.03.2022 deri më 01.04.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.50 ha** me mollë;
- Periudha siguruese për pemishtet me mollë duhet të jetë prej 20.03.2022 deri më 15.05.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.50 ha** me kumbull;
- Periudha siguruese për pemishtet me kumbull duhet të jetë prej 20.03.2022 deri më 15.05.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.10 ha** me vresht;
- Periudha siguruese për sieperfaqen e vreshtit duhet të jetë prej 20.03.2022 deri më 15.05.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.30 ha** me spec;
- Periudha siguruese për sieperfaqen e mbjellur me spec duhet të jetë prej 15.05.2022 deri më 10.06.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.50 ha** me arrë;
- Periudha siguruese për pemishtet me arrë duhet të jetë prej 20.03.2022 deri me 15.05.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.50 ha** me qershi;
- Periudha siguruese për pemishte me qershi duhet të jetë prej datës 20.03.2022 deri më datën 15.05.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **1 ha** me misër;
- Periudha siguruese për misër duhet të jetë prej datës 25.06.2022 deri më datën 25.07.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.30 ha** me fasule;
- Periudha siguruese për fasule duhet të jetë prej datës 25.06.2022 deri më datën 05.08.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.5 ha** me dardhë;
- Periudha siguruese për pemishte me dardhë duhet të jetë prej datës 20.03.2022 deri më datën 15.05.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.50 ha** me vishnje;
- Periudha siguruese për pemishte me vishnje duhet të jetë prej datës 20.03.2022 deri më datën 15.05.2022;

**6. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT PER PRIMET E SIGURIMIT BUJQESOR TRADICIONALE (BRESHERI):**

**Kriteret për primet e sigurimit bujqësor tradicional (breshër):**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **1 ha** me mollë;
- Periudha siguruese për pemishtet me mollë kundër breshërit duhet të jetë prej 15.05.2022 deri me 30.09.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.50 ha** me spec;
- Periudha siguruese për sipërfaqen e mbjellur me spec duhet të jetë prej 10.07.2022 deri me 30.09.2022;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.50 ha** me vreshtë-rrush i verës ;
- Periudha siguruese për sipërfaqen e vreshtit-rrush i verës duhet te jete prej 15.05.2022 deri me 30.09.2022.

**7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kopja e Certifikatës së regjistrimit të biznesit-ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm per personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit te biznesit (vetëm per personat juridik);
- Polisa e sigurimit për kulturën përkatëse, e cila duhet të ketë mbulim për periudhën e sigurimit të perkacktuar tek kriteret për kulturat bujqësore;
- Dëshmi mbi pagesën e polisës së sigurimit;

**8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Do të behet pagesa **75 %** e shumës së primit, për fermerët, në formë të subvencionit, si masë paraprake për tejkalimin e dëmeve të shkaktuara respektivisht nga rreziqet e përcaktuara në Polisën e Sigurimit, për të mbuluar dëmet që mund t'iu shkaktohen fermerëve të cilët kanë paguar sigurimin bujqësor.
- Shuma e mjeteve në vlerë prej **75 %** të primit, si subvencion, i ekzekutohet direkt fermerit, pasi të paraqes dëshminë e pagesës së primit, së bashku me polisën e sigurimit dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

## **9. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimi të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues sipas pagesës së primit dhe përqindjes së përkrahjes së primit.

Pagesat bëhen në xhironlogarit bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

**Sqarim:** të gjitha informacionet për blerjen e Polisave të Sigurimit dhe të gjitha detajet lidhur me specifikat e sigurimit bujqësor për mjedër, mollë, kumbull, rrush, dredhëz dhe spec (periudha e sigurimit, kufijtë e paracaktuar dhe dëmshpërblimet në rast të ndodhjes së rrezikut dhe shkakimit të dëmit, shuma e siguruar si dhe shuma e primit të sigurimit të cilën duhet fermerët ta paguajnë) mund të merren në shoqaten e sigurimeve të Kosovës. Pagesa e primit të sigurimit index do të jetë e ndryshme, varësisht lokacionit në të cilin ndodhen sipërfaqet e mbjellura me mjedër, mollë, kumbull, rrush, dredhëz, spec, arrë, fasule, misri, qershisë, vishnjës dhe dardhës si dhe primin e sigurimit bujqësor tradicional për kulturat bujqësore: mollën, specin, dhe rrushin e verës

## **10. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale përkatëse për Bujqësi.

## **11. ZBATIMI I PROGRAMIT**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **PAGESAT DIREKTE PËR PRODHIMIN E MATERIALIT FIDANOR TË PEMËVE DRUFRUTORE DHE HARDHISË SË RRUSHIT**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - RËNDËSIA E MATERIALIT FIDANOR:**

Zhvillimi i suksesshëm i pemëtarisë intensive varet në radhë të parë nga prodhimtaria cilësore e materialit fidanor, nga varietete më të mira të përfituara përmes seleksionimit klonal, të kultivuara në nënshartesat më të përshtatshme.

Suksesi në krijimin e pemishteve intensive komerciale, në radhë të parë varet nga cilësia e fidanëve, prandaj kësaj prodhimtarie gjithmonë duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë, sidomos sigurimit të materialit fillestar, i cili para së gjithash duhet të jetë i shëndoshë për nga gjendja shëndetësore dhe pastërtia varietore, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet prodhimtaria e qëndrueshme e pemishtes.

Spektori i pemëtarisë e veçanërisht prodhimtaria e fidanëve konsiderohet sektor me rëndësi ekonomike. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet përmirësimi i teknikave të prodhimit të fidanëve të pemëve dhe aplikimit të teknologjive të reja që bëjnë të mundur rritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe shtimin e numrit të fidanëve të pemëve drufrutore.

## **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrueshmërisë dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte në prodhimin e fidanëve të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti.

Ngritja e cilësisë, rritja e numrit të fidanëve të pemëve drufrutore, shtimi i të ardhurave të fermerëve si dhe rritjet e çmimit të inputeve bujqësore janë edhe arsyet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e fermerëve të cilët veprojnë në këtë sektor dhe resurset natyrore të vendit.

## **3. QËLLIMI PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve / subjekteve të cilët prodhojnë fidanë të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit.

### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e sipërfaqeve të mbjella me pemë drufrutore;
- Rritja e sipërfaqeve të mbjella me vreshtë;
- Rritja e të hyrave në fermë;
- Zvogëlimi i importit;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

### **3.2. Objektivat specifike:**

- Përmirësimi i cilësisë së materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit;
- Aplikimi i teknologjive bashkëkohore - mbjellja intensive;
- Përmirësimi i strukturës varietore;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit të fidanëve të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit.

## **4. PËRFITUESIT:**

### **4.1. Fermerët / subjektet që prodhojnë material fidanor të pemëve dhe hardhisë:**

- Përfitues do të jenë fermerët/subjektet të cilët prodhojnë material fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

## **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Fermeri/subjekti duhet të jetë i licencësuar në MBPZHR-së për prodhimin e materialit fidanor të pemëve;

- Fermeri / subjekti duhet të jetë i licencësuar në MBPZHR-së për prodhimin e materialit fidanor të hardhisë së rrushit;
- Fermeri/subjekti, gjatë vitit kalendarik 2022, duhet të prodhojë së paku 5000 fidanë të pemëve drufrutore ose hardhisë së rrushit;
- Subvencionimi bëhet vetëm për fidanët njëvjeçare.

## 6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Procesverbal nga Inspektori Fitosanitar - AUV për posedimin e pemishtës amë të nënshartesave vegjetative;
- Procesverbal nga Inspektori Fitosanitar - AUV për posedimin e vreshtit amë të nënshartesave vegjetative;
- Për nënshartesat vegjetative të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit të importuara, fermeri - subjekti duhet të posedojë këtë dokumentacion: certifikatën fitosanitare për gjendjen shëndetësore të nënshartesave vegjetative të lëshuar nga shteti prej të cilit janë importuar ato, dhe dokumentin unik doganor (DUD) që dëshmon se nënshartesat kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të rregullt përmes doganës;
- Kopja e deklaramit të sasisë së prodhuar të fidanëve për vitin kalendarik 2022, të vërtetuar/nënshkruar dhe vulosur nga Inspektori Fitosanitar - AUV (ky dokument sillet/dorëzohet pasi të kryhet deklarimi i sasisë së prodhuar të fidanëve, më së largu me 30 nëntor);
- Kopja e certifikatës fitosanitare mbi gjendjen shëndetësore të fidanëve të prodhuar në vitin kalendarik 2022 (ky dokument sillet/dorëzohet pas kryerjes së analizave të fidanëve për gjendjen shëndetësore, më së largu me 30 nëntor).

## 7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për numër të fidanëve të prodhuar;
- Fermerët që prodhojnë së paku 5000 deri 40,000 fidanë të pemëve drufrutore do të subvencionohen në vlerë prej 0.25 €/fidan;
- Fermerët që prodhojnë mbi 40,000 fidanë të pemëve drufrutore do të subvencionohen në vlerë prej 0.25 €/fidan për 40,000 fidanët e parë dhe në vlerë prej 0.20 €/fidan për çdo fidan tjetër mbi këtë numër.
- Fermerët që prodhojnë së paku 5000 e më shumë fidanë të hardhisë së rrushit do të subvencionohen në vlerë prej 0.15 €/fidan;

## **8. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve do të zgjas 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale përkatëse për Bujqësi.

## **9. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve dhe kompletimit të dokumentacionit bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të fidanëve të prodhuar dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve/subjekteve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

## **10. ZBATIMI I PROGRAMIT**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **PAGESAT DIREKTE PËR BIMË MJEKSORE DHE AROMATIKE / BMA**

### **1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - RËNDËSIA BMA-ve:**

Sektori i BMA-ve është relativisht i ri në Kosovë por viteve të fundit ka një trend pozitiv të zhvillimit me rritjen e eksporteve në vendet e BE-s, andaj konsiderohet sektorë me rëndësi strategjike dhe ekonomike për vendin tonë, që bazohet në resurset natyrore dhe angazhimin e një numri të madh të fuqisë punëtore. Rëndësia e këtij sektori qëndron edhe në ndikimin që ka në zhvillimin e sektorëve të tjerë, si në sektorin e prodhimit të materialit fidanor për prodhimin e BMA-ve dhe në sektorin e agro-përpunimit.

Aktualisht në Kosovë janë të mbjella rreth 1,040 ha me BMA, ku kultivohen rreth 45 lloje të BMA-ve, por vetëm disa lloje janë me kryesore dhe që zënë sipërfaqe më të mëdha.

Kërkesa për eksport të BMA-ve po rriten ç' do vit sepse këto kultura po kërkohen nga industritë e ushqimit, farmaceutikes dhe kozmetikes. Edhe pse përpunuesit/eksportuesit në bashkëpunim me donatorët e ndryshëm kanë financuar zgjerimin e kultivimit të BMA-ve, kërkesat e përpunuesve/eksportuesve për lënde të parë është ende e madhe.

Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit kërkohet mbështetje përmes pagesave direkte nga MBPZHR. Kjo mbështetje do të ndikojë drejtpërdrejtë në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit, rritjen e sipërfaqeve si dhe do të krijonte mundësinë e rritjes së eksportit në vendet e BE-së. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet mirëmbajtje e vazhdueshme e sipërfaqeve aktuale dhe zgjerimi i sipërfaqeve të reja me BMA.

### **2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e sipërfaqeve të tokës bujqësore të mbjella me BMA do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, rritja e të ardhurave të fermerëve, zgjerimi i sipërfaqeve me BMA, rritja e eksportit në vendet e BE-se, diversifikimi i prodhimit, ndalimi i migrimit nga



zonat rurale në zonat urbane, angazhimi i numrit të madh të fermerëve (*te rinjtë dhe gjinia femërore*) të cilët merren me këtë sektor, rritjet e çmimit të inputeve bujqësore si dhe resurset natyrore të vendit janë arsytet e përkrahjes së këtij sektori.

### **3. QËLLIMI I PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët merren me kultivimin e BMA.

#### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e sipërfaqeve të mbjellura me BMA;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

#### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e sipërfaqeve me BMA;
- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;
- Rritja e eksportit të MBA.

### **4. PËRFITUESIT:**

4.1. Fermerët të cilët merren me mbjelljen/kultivimin e BMA-ve.

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellura/kultivojnë BMA dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

4.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

### **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 0.10 ha me BMA;
- Parcela e mbjellë me BMA duhet të jetë së paku 0.05 ha e pandarë;
- Të deklarojnë nën betim, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit;

### **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirrollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);

- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqës për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojn në momentin e aplikimit.

#### **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe-hektar, në vlerë prej 450 €/ha;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellur/kultivojnë së paku 0.10 ha me bimë mjeksora - aromatike/BMA dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve dhe kompletimit të dokumentacionit bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve /aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

#### **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjas 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

#### **10. ZBATIMI I PROGRAMIT:**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

*Tab.4. Llojet kryesore të BMA-ve që kultivohen në Kosovë dhe që do të mbështeten përmes programit të pagesave direkte*

Nr	Emri në gjuhën Shqipe	Emri në gjuhën Latine
1	Kamomili	Matricaria chamomilla
2	Hithra	Urticia dioica
3	Rigoni	Origanum vulgare dhe heracleoticum
4	Menta	Mentha pipertia dhe spicata
5	Sherbela	Salvia officinalis
6	Bari i bletës	Melissa officinalis
7	Mullaga e bardhë	Althea officinalis L.
8	Lavanda	Lavandula angustifolia
9	Mëllaga e zeze	Malva sylvestris
10	Ciani / Koke qeli - te kuq, te kaltër dhe te bardh	Centaurea cyanus
11	Kalendula	Calendula officinalis
12	Borziloku	Ocimum basilicum
13	Agulicja	Primula veris L
14	Rozmarina	Rosmarinus officinalis

15	Levistika	<i>Levisticum officinale</i>
16	Kaqa - trendalifi i egër	<i>Rosa canina</i>
17	Luleshurdha mjekësore	<i>Taraxacum officinale</i>
18	Finoku	<i>Foeniculum vulgare</i>

## PAGESAT DIREKTE PËR PRODHIMTARI ORGANIKE

### 1. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - RËNDËSIA E BUJQËSISË ORGANIKE:

Prodhimtaria organike në Kosovë është ende në fazë të hershme të zhvillimit, si në prodhim ashtu edhe në konsum, mirëpo sa i përket mundësisë së zhvillimit të këtij sektori konsiderohet se Kosova ka kushte natyrore mjaftë të përshtatshme për zhvillimin e saj.

Duke marrë parasysh se kostoja e certifikimit për prodhimtari organike është mjaft e lartë, ajo edhe ndikon në rritjen e kostos së prodhimit, prandaj subvencionimi i këtij nën sektori është i nevojshëm për konsolidimin e mëtejshëm të tij.

### 2. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ka për qëllim promovimin dhe përkrahjen e zhvillimit të bujqësisë organike në Kosovë.

Kosova ka potencial për zhvillimin e bujqësisë organike duke u bazuar në mënyrën tradicionale të kultivimit, sidomos në zonat e thella rurale si dhe kërkesën e madhe të këtyre prodhimeve në tregjet e BE - së.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, mbrojtja e ambientit, ruajtja e gjendjes së mirë të tokës, ndalimi i migrimit nga zonat rurale, ulja e kostos së prodhimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë arsye të përkrahjes së këtij sektori.

### 3. QËLLIMI I PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët merren me prodhimtari organike.

#### **3.1. Objektivat e programit:**

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e sipërfaqeve me prodhimtari organike;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë.

#### **3.2. Objektivat specifike:**

- Rritja e sipërfaqeve me prodhimtari organike;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;
- Rritja e eksportit të prodhimeve organike.

#### **4. PËRFITUESIT:**

##### **4.1. Fermerët të cilët merren me prodhimtari organike.**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët të cilët merren me prodhimtari organike.

##### **4.2. Shtrirja gjeografike:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

#### **5. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.10 ha** me kultura bujqësore me qëllim të prodhimit organik;
- Parcela e mbjellë me kultura bujqësore me qëllim të prodhimit organik duhet të jetë së paku **0.05 ha** e pandarë;
- Fermerët/aplikuesit, në momentin e aplikimit duhet të deklarojnë se cila kulturë bujqësore është e mbjelle në parcelën/ngastrën për të cilën aplikojnë.
- Të deklarojnë nën betim, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit;

#### **6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirrologarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Dëshmia/Certifikata për certifikimin organik, për ngastrën dhe kulturën bujqësore të mbjellë në të. Dëshmia lëshohet nga trupa e kontrollit (trupa certifikuese) e akredituar në nivel të BE-së dhe duhet të dorëzohet pasi të realizohet certifikimi organik për ngastrën dhe kulturën bujqësore që është e mbjellur në atë ngastër;
- Lista e produkteve të certifikuara (aneksi);
- Lista e parcelave, të vulosur nga trupa e kontrollit (trupa certifikuese) e akredituar në nivel të BE-së;
- Deklarata nën betim e noterizuar, për saktësin dhe vërtetësin e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.

#### **7. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe-hektar, në vlerë prej **50 €/ha** dhe është vlerë shtesë mbi subvencionimin bazë të kulturës së caktuar bujqësore (p.sh. për drithërat, subvencionimi bazë është 150, 170, 175 €/ha, për perime në fushë të hapur subvencionimi bazë është 500 €/ha, për perime në serra subvencionimi bazë është 600 €/ha, për perime në fushë të hapur-kunguj dhe kunguj të misirit subvencionimi bazë është 150 €/ha, për

pemë subvencionimi bazë është 450 €/ha, për vreshta subvencionimi bazë është 1000 €/ha, për bimët mjekësore - aromatike (BMA) subvencionimi bazë është 450 €/ha, atëherë nëse arrin të certifikohet si prodhim organik, fermeri merr edhe shtesën prej 50 €/ha;

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë së paku 0.10 ha me kultura bujqësore dhe për të cilën sjellin/dorëzojnë dëshminë e certifikimit për prodhim organik dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

## **8. REALIZIMI I PAGESAVE:**

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve dhe kompletimit të dokumentacionit bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të Certifikuar si prodhimtari organike dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve / aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

**Sqarim:** Prodhimtaria organike ka specifika të veçanta të prodhimit në krahasim me prodhimet e tjera, prandaj gjatë zbatimit të Programit të Pagesave Direkte për sektorin e prodhimit organike duhet pasur kujdes, pasi që fermerët aplikojnë për sipërfaqe të caktuar, por certifikimi i sipërfaqes realizohet nga trupa e kontrollit (trupa certifikuese) dhe në fund të procesit të certifikimit mund të mos certifikohet e tërë sipërfaqja për të cilën ka aplikuar fermeri. Në këtë rast duhet realizuar pagesa vetëm për sipërfaqen që është certifikuar për prodhimtari organike, por jo edhe të merren masat ndëshkimore për sipërfaqen e cila nuk ka arritur t'i plotësojë kriteret për certifikim organik, pasi që kjo nuk nënkupton tentim për mashtrim nga ana e fermerit, por mos arritje të përmbushjes së standardeve - kriterëve për certifikim të prodhimit organik.

## **9. MËNYRA E APLIKIMIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjas 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale për Bujqësi.

## **10. ZBATIMI I PROGRAMIT**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

**PAGESAT DIREKTE PËR: LOPË DHE BUALLICA QUMËSHTORE, DELE, DHI, DOSA PËR RIPRODHIM, BLETË, QUMËSHT SIPAS KATEGORIVE TË CILËSISË, PULA VOJSE, AKUAKULTURË, THERJET E RAPORTUARA TË GJEDHIT DHE VIÇA PËR MAJMËRI**

## **1. LEGJISLACIONI REFERUES:**

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27.07.2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16.10.2012);

- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25.03.2009);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12.01.2009);
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16.10.2012);
- Ligji Nr.05/L-031 për Procedurat e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr.20/21.06.2016);
- Ligji Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 ( Gazeta Zyrtare Nr.13/31.12.2021);
- Ligji Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës (Gazeta Zyrtare Nr. 14 /17 Korrik 2019);
- Ligji Nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Gazeta Zyrtare: 16/26 Qershor 2015);
- Ligji Nr. 03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare /Nr. 90/1 dhjetor 2010);
- Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë;
- Ligji Nr. 2004/21 për Veterinarinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/01.11.2007);
- Ligji Nr. 04/L-191 për Blegtorinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 25/08.07.2013);
- Ligji Nr. 02/L-10 për Përkujdesjen Ndaj Kafshëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 5/ 01.10.2006);
- Ligji Nr. 02/L-111 për Bletari (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 35/15.08.2008);
- Ligji Nr.02/L-85 Për Peshkatari dhe Akuakulturë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.24/01.05.2008);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr. 9/2008 Për Licencimin e aktiviteteve të Akuakulturës;
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2022.

## **2. RËNDËSIA E BLEGTORISË - PËRSHKRIMI I SEKTORIT**

Sektori i blegtorisë zë një vend të rëndësishëm në kuadër të prodhimitarisë bujqësore, duke pasur parasysh që vendi ynë ka resurse të mjaftueshme për zhvillimin e tij. Në sektorin e blegtorisë prodhohen ushqime me vlerë të lartë, si: qumësht, mish, vezë dhe prodhime bletare, andaj ky sektor ndikon drejtpërdrejtë edhe në zhvillimin e prodhimitarisë bimore dhe industrisë agro - përpunuese.

Pavarësisht rezultateve inkurajuese në ngritjen e prodhimitarisë, përmirësimin e cilësisë së prodhimeve dhe resurset të cilat i disponon vendi për zhvillimin e blegtorisë, megjithatë në këtë sektor janë evidente vështirësi të cilat mund të ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm të aktiviteteve blegtorale. Pamundësia e fermerëve për investime me qëllim të rritjes së kapaciteteve, pastaj sistemi kreditues i pavolitshëm, paraqesin vështirësi për prodhimitarinë vendore dhe perspektivën e sektorit.

### **3. ARSYESHMËRIA E MASËS:**

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh intensifikimin e aktiviteteve blegtorale me qëllim të shfrytëzimit të resurseve natyrore të cilat i disponon vendi dhe krijimin e një bujqësie/blegtorie të konsoliduar fitimprurëse me prodhimtari konkurrenë në rajon dhe garanci për shëndetin e konsumatorit.

Ngritja e prodhimtarisë kërkon edhe ngritjen kapaciteteve përpunuese dhe intensifikimin e shkallës së shfrytëzimit të tyre. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ngritjes së nivelit të sigurisë së ushqimit, gjë që pretendohet të arrihet përmes:

- Ngritjes së madhësisë së fermave dhe modernizimit të teknologjive;
- Aplikimit të standardeve të sigurisë së ushqimit;
- Minimizimit të efekteve anësore në ndotjen e ambientit.

### **4. QËLLIMI PROGRAMIT:**

Mbështetja direkte për fermerët mbarështues të lopëve dhe buallicave qumështore, deleve, dhive, bletëve, dosave për riprodhim, pulave vojse, thëllëzave, qumështit të freskët (Klasa ekstra, Klasa I-rë dhe Klasa II-të), therjeve të raportuara të gjedhit dhe akuakulturës.

### **5. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT:**

#### **5.1 Objektivat e përgjithshme:**

- Përmirësimi i të hyrave në fermë;
- Rritja e madhësisë së fermës dhe
- Siguria e ushqimit.

#### **5.2 Objektivat specifike:**

- Përmirësimi i cilësisë së prodhimeve blegtorale;
- Mirëmbajtja e bazës së të dhënave dhe Sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve AUV;
- Zvogëlimi i ndikimit negativ në mjedis;
- Ndalimi i qarkullimit ilegal të kafshëve;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;
- Nxitja e aktiviteteve të fermerëve dhe aftësisë konkurruese.

### **6. PAGESAT DIREKTE PËR LOPË DHE BUALLICA QUMËSHTORE**

Gjedhët (duke përfshirë edhe buallicat) janë popullacioni më i madh i kafshëve dhe si i tillë janë bartës të prodhimtarisë së qumështit dhe mishit, prandaj prodhimtaria e gjedhit është veprimtari e pjesës dërmuese të fermave komerciale dhe ekonomive familjare.

Fondi i gjedhit në Kosovë është rreth 261,389 krerë prej të cilave për prodhimtarinë e qumështit janë 133,916 krerë lopë dhe 347 buallica.

#### 6.1. PËRFITUESIT:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë lopë ose buallica qumështore në të gjitha fazat e prodhimit të qumështit dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### 6.2. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

#### 6.3. KRITERET QË DUHET T'Ë PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT :

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë së paku 5 krerë lopë qumështore ose buallica qumështore ose së paku 5 krerë lopë qumështore dhe buallica qumështore së bashku;
- Në kohën/ ditën e aplikimit, mosha e kafshëve duhet me qen së paku 22 muaj deri në 12 vjet;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara me matriculë të Republikës së Kosovës ose shteteve të BE-së;
- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Numri i kafshëve në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar;

#### 6.4. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirrollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Regjistri për vitin 2022 i lëshuar nga Praktikat Veterinare të kontraktura nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur në të gjitha fletët/faqet;

#### 6.5. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për krerë, në vlerë prej 90 €/krerë;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë së paku 5 krerë lopë qumështore ose buallica qumështore ose së paku 5 krerë lopë qumështore dhe buallica qumështore së bashku dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.



## **7. PAGESAT DIREKTE PËR DELET DHE DHITË**

Delet dhe dhitë dominojnë në zonat e thella rurale dhe si të tilla janë bartëse të prodhimtarisë blegtorale. Fondi i deleve dhe dhive në Kosovë është rreth 241,688 krerë, prej të cilave në prodhimtarinë e qumështit janë rreth 145,248 krerë dele dhe 27,197 krerë dhi.

### **7.1. PËRFITUESIT :**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë dele ose dhi qumështore në të gjitha fazat e prodhimtarisë së qumështit dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

### **7.2. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

### **7.3. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë së paku 30 krerë dele qumështore ose së paku 20 krerë dhi qumështore, në prodhimtarinë aktive të qumështit;
- Në kohën/ditën e aplikimit, mosha e kafshëve duhet me qenë së paku 12 muaj deri në 7 vjet;
- Kafshët duhet të jenë të matrikulluara me matriculë të Republikës së Kosovës ose shteteve të BE-së;
- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Numri i kafshëve në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar.

### **7.4. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirrollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Regjistri për vitin 2022 i lëshuar nga Praktikat veterinarë të kontraktura nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur në të gjitha fletët/faqet;

### **7.5. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për krerë, në vlerë prej 25 €/krerë;

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë së paku 30 krerë dele qumështore ose së paku 20 krerë dhi qumështore), dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

## **8. PAGESAT DIREKTE PËR BLETË**

Vendi ynë ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e bletarisë duke u bazuar në kushtet klimatike, reliefit dhe numrit të madh të bimëve mjaltëdhënëse, të cilat garantojnë prodhimtari rentabile dhe cilësore të mjaltit dhe prodhimeve bletare. Fondi i shoqërive të bletëve / koshereve në Kosovë është rreth 262,541 koshere.

### **8.1. PËRFITUESIT:**

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë bletë dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

### **8.2. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

### **8.3. KRITERET QË DUHET T'Ë PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë së paku 30 shoqëri bletësh (koshere), me përjashtim të nukleusit;
- Fermerët që kanë 30 deri 100 shoqëri bletësh (koshere) mund t'i kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) maksimumi në dy (2) bletishte, fermerët që kanë mbi 100 deri 200 shoqëri bletësh (koshere) mund t'i kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) maksimumi në tri (3) bletishte, fermerët që kanë mbi 200 deri 400 shoqëri bletësh (koshere) mund t'i kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) maksimumi në katër (4) bletishte, fermerët që kanë mbi 400 shoqëri bletësh (koshere) mund t'i kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) maksimumi në pesë (5) bletishte;
- Fermerët aplikues, në bletishten bazë duhet të kanë së paku 30 shoqëri bletësh;
- Kosheret duhet të jenë të shënuara qartë me Numrin Identifikues të Fermës (NIF), me ngjyrë permanente;
- Kosheret duhet të posedojnë mbi gjashtë (6) korniza;
- Në momentin e kontrollit të fermerit / aplikuesit, në rast se i mungon numri Identifikues i Fermës (NIF) në koshere, atëherë përjashtohet nga subvencionimi secila koshere pa numrin Identifikues të fermës (NIF) të shënuar;

### **8.4. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);

- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e certifikatës për prodhimin organik të mjaltit e cila duhet t'i bashkëngjitet dokumentacionit të aplikimit jo më larg se 10 ditë nga data e certifikimit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga trupa e kontrollit (trupa certifikuese) e akredituar në nivel të BE-së (vlen vetëm për fermerët e certifikuar për prodhimin e mjaltit organik);
- Dëshmi individuale nga ana e vet fermerit për numrin e shoqërive të bletëve dhe vendndodhjen e shoqërive të bletëve, e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Drejtoria Komunale përkatëse për Bujqësi – Komuna, përjashtimisht komunave: Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq, ku dëshmia pranohet pa llogo edhe pa qen e vulosur por vetëm e nënshkruar.

#### **8.5. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për shoqëri bletësh (koshere), në vlerë prej 20 €/shoqëri bletësh (koshere), ndërsa fermerët e certifikuar për prodhimtari organike të mjaltit subvencionohen në vlerë prej 25 €/shoqëri bletësh (koshere);
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë së paku 30 shoqëri bletësh (koshere) dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **9. PAGESAT DIREKTE PËR PULA VOJSE**

Spektori i shpezëtarisë, posaçërisht prodhimi i vezëve për konsum është shumë i rëndësishëm dhe mjaft i ndjeshëm në Kosovë, për shkak të strukturës së fermave.

Shpezëtaria ndër vite ka pasur rritje të konsiderueshme falë ekzistimit të kapaciteteve. Sipas të dhënave numri i përgjithshëm i shpezëve është rreth 2,782,000 copë, ndërsa pula vojse janë rreth 1,939,000 copë.

Në Kosovë janë mbi 170 ekonomi bujqësore që posedojnë më shumë se 2,000 pula vojse dhe numri i përgjithshëm i pulave në keto ekonomi është 2,000,000 copë, ndërsa pjesa tjetër janë në fermat familjare.

Konsumi mesatar për kokë banori llogaritet të jetë 203 vezë/vit, dhe mund të thuhet se Kosova plotëson rreth 97% të nevojave për konsum të vezëve.

#### **9.1. PËRFITUESIT:**

Përfitues do të jenë fermerët/subjektet mbarështues të pulave vojse në të gjitha fazat e prodhimtarisë aktive të vezëve, dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **9.2. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

#### **9.3. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë së paku **2000 pula vojse** në të gjitha fazat e prodhimtarisë aktive të vezëve;
- Aplikuesi/ subjektet duhet të jetë i regjistruar në AUV;

- Aplikuesi/ subjekti duhet të aplikoj programin e vaksinimit;
- Aplikuesi/ subjekti duhet të aplikon vulosjen e vezëve për treg.

#### 9.4. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e dëshmisë për numrin dhe origjinën e zogjve një ditor për pula vojse ose të pulave vojse, fatura e furnizimit nga importuesi dhe prodhuesi;
- Për pulat vojse (16 -18 javëshe) dhe zogjtë një ditor (8-10 ditor) për pulat vojse, fatura e furnizimit vlenë nga data 01 qershor 2021 deri me 31 tetor 2022;
- Certifikata shëndetësore - veterinare e lëshuar nga Praktikat Veterinare të licencuara nga AUV;
- Dëshmia-vërtetimi nga veterinari për aplikimin e programit të vaksinimit;
- Dëshmia se aplikon vulosjen e vezëve për treg;

#### 9.5. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për pulë vojse në të gjitha fazat e prodhimtarisë aktive të vezëve sipas madhësisë së tufës;
- Fermeret-subjektet që mbarështojn së paku 2000 deri 10000 pula vojse do të subvencionohen në vlerë prej 0.50 €/pulë vojse;
- Fermeret-subjektet që mbarështojn mbi 10000 pula vojse do të subvencionohen në vlerë prej 0.50 €/pulë vojse për 10000 pulat e para dhe në vlerë prej 0.40 €/pulë vojse për çdo pulë vojse tjetër mbi këtë numër;
- Subvencionimi bëhet vetëm për një turnus të prodhimtarisë brenda vitit kalendarik.

**Sqarim:** në rast së subjektet / aplikuesit e realizojnë ndërrimin e turnusit të pulave vojse mbas thirrjes për aplikim, atëherë duhet që të sjellin në AZHB faturat e furnizimi para se të realizohet kontrolla në teren nga ana e Inspektorëve të AZHB-së.

### 10. PAGESAT DIREKTE PËR DOSAT PËR RIPRODHIM

Derri shfrytëzohet për prodhimtarinë e mishit dhe atë kryesisht në ekonomitë familjare. Sipas të dhënave nga analizat zooteknike rezulton se shkalla e shtimit të derrave në vend është 2 pjellje në vit me mesatare 8 gica/pjellje. Fondi i derrave në Kosovë është rreth 45,394 krerë, ndërsa i dosave për riprodhim është mbi 19,000 krerë.

Prodhimtaria e mishit të derrit është orientuar në plotësimin e nevojave të ekonomive familjare me tendencë ngritjen në nivel të fermave komerciale.

#### **10.1. PËRFITUESIT:**

Përfitues sipas këtij programi do të jenë fermerët që mbarështojnë dosa për riprodhim në të gjitha fazat e riprodhimit dhe të cilët i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

#### **10.2. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

#### **10.3. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë së paku 2 dosa për riprodhim aktiv në të gjitha fazat e riprodhimit;
- Në kohën/ditën e aplikimit, moshë e kafshëve duhet me qen së paku 15 muaj deri në 5 vjet;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara me matriculë të Republikës së Kosovës ose shteteve të BE-së;
- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Numri i kafshëve në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar;

#### **10.4. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Regjistri për vitin 2022 i lëshuar nga Praktikat veterinare të kontraktura nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur në të gjitha fletët/faqet;

#### **10.5. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për krerë, në vlerë prej **25 €/krerë**;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë së paku 2 krerë dosa për riprodhim dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

### **11. REALIZIMI I PAGESAVE PËR KRERË TË BAGËTIVE, SHOQËRI TË BLETËVE - KOSHERE DHE PULA VOJSE ;**

Realizimi i pagesave direkte për lopë qumështore, buallica qumështore, dele, dhi, dosa për riprodhim, bletë dhe pula vojse do të bëhet pas kompletimit të dokumentacionit dhe hartimit të listave përfundimtare të përfituesve, sipas numrit të krerëve, numrit të shoqërive të bletëve -

koshereve dhe numrit të pulave vojse të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

#### **12. THIRRJA PËR APLIKIM PËR PAGESA DIREKTE PËR KRERË TË BAGËTIVE, KOSHERE TË BLETËVE, PULAVE VOJSE DHE THËLLËZAVE:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve/aplikuesve për pagesa direkte për lopë qumështore, buallica qumështore, dele, dhi, dosat për riprodhim, bletë dhe pula vojse, do të zgjasë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale përkatëse për Bujqësi.

#### **13. ZBATIMI I PROGRAMIT:**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

#### **14. PAGESAT DIREKTE PËR QUMËSHIT SIPAS KATEGORIVE TË CILËSISË**

Prodhimtaria e qumështit është veprimtari e pjesës dërmuese të fermerëve/blegëtorve komercial dhe ekonomive familjare. Sektori i qumështit është prioritet i aktiviteteve blegtorale për shkak të rëndësisë ekonomike dhe efekteve pozitive në zhvillimin e sektorëve tjerë bujqësorë (prodhimtarisë lavërtarë, prodhimtarisë së mishit, industrisë përpunuese etj.).

Bartës të prodhimtarisë së qumështit janë fermat komerciale të gjedhëve dhe dheneve. Konsumi i qumështit në shkallë vendi vlerësohet të jetë 353,089 ton/vit, ku përmes prodhimit vendorë vlerësohet se plotësohen rreth 80.1% e konsumit ose 277,846 ton/vit.

Sipas të dhënave nga Laboratori i Kontrollit në AUV (Raporti i Projektit Transparenca dhe neutraliteti në marrjen e mostrave dhe pagesën e qumështit të freskët), përmirësimi i cilësisë së qumështit ka shënuar ngritje të vazhdueshme. Sipas rezultateve të analizave ka ngritje të cilësisë së qumështit për klasat që mbështeten përmes programit për pagesa direkte për 9.5%, gjithnjë sipas raportit të analizave të realizuara, rezulton se qumështit i freskët me destinacion industrinë përpunuese për Klasën Extra arrinë në 43.90 %, Klasa I-rë 3.18 % dhe Klasa II-të me 15.14%.

##### **14.1.PËRFITUESIT:**

- Përfitues do të jenë fermerët prodhues të qumështit: Klasa ekstra, Klasa I-rë dhe Klasa II-të sipas standardeve të kategorizimit bazuar në legjislacionin në fuqi.

##### **14.2.SHTRIRJA GJEOGRAFIKE:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

##### **14.3.KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, numri i kafshëve në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar;
- Të kenë kontratë, të vërtetuar nga noteri, për shitjen e qumështit në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështorë të licencuar;
- Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështorë ose pikën e grumbullimit të qumështit e cila është e regjistruara si biznes dhe ka kontratë me ndonjërin qumështorë të licencuar. I pranueshëm për pagesë është qumështi i kategorive: Klasa Ekstra, Klasa I-rë dhe Klasa II-të;
- Të dorëzojnë së paku 3000 litra qumësht për 6 (gjashtë) muaj (sipas gjashtëmujorëve të vitit kalendarik);
- Të ofrojnë dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështorë të licencuar;
- Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

#### 14.4. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për persona juridikë);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridikë);
- Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridikë);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridikë);
- Kopja e listës së verifikimit të kafshëve: gjedhët, dhentë dhe dhitë, të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I & R) në kuadër të AUV;
- Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështorë të licencuar;
- Dëshmia për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështorë ose në pikën e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznes dhe e cila ka kontratë me ndonjërin qumështorë të licencuar;
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të pikës grumbulluese dhe kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, të pikës grumbulluese me ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
- Dëshmia e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të shitur (dorëzuar);
- Dëshmia për pjesëmarrjen në projektin "Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit" (e lëshuar nga Projekti "Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit").

#### 14.5. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar, sipas kategorive:

1. Ekstra klasë = 0.07 €
2. Klasa e Parë = 0.04 €
3. Klasa e Dytë = 0.02 €

#### **14.6. REALIZIMI I PAGESAVE PËR QUMËSHT SIPAS KATEGORIVE TË CILËSISË:**

Realizimi i pagesave direkte për qumështin sipas kategorive të cilësisë, bëhet pas hartimit të listave përfundimtare të fermerëve/përfituesve sipas kategorisë së cilësisë së qumështit. Pagesat bëhen në xhirrollogaritë bankare të fermerëve/përfituesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

#### **14.7. THIRRJA PËR APLIKIM PËR PAGESA DIREKTE TË QUMËSHTIT SIPAS KATEGORIVE TË CILËSISË:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve/aplikuesve për pagesa direkte të qumështit sipas kategorive të cilësisë do të publikohet/shpallet çdo 6 (gjashtë) mujor dhe do të zgjasë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

#### **14.8. ZBATIMI I PROGRAMIT:**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

### **15. PAGESAT DIREKTE PËR THERJET E RAPORTUARA TË GJEDHIT**

Fondi i gjedheve, është rreth 261,389 krerë, raportohet se gjatë vitit theren rreth 116,048 krerë. Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë për mish gjedhi është 52.2% të konsumit presj 21 kg/për kokë banori / vit.

Nga therjet e raportuara vetëm një numër i vogël i krerëve, rreth 12,000 krerë, theren në thertoret e licencuara, ndërsa pjesa tjetër theren në menyrë ilegale në thertore të pa licencuar dhe ekonomi familjare. Therjet ilegale ndikojnë negativisht në ruajtjen e shëndetit të kafshëve, shëndetit publik dhe në ruajtjen e mjedisit.

#### **15.1.PËRFITUESIT:**

Përfitues do të jenë thertoret e licencuara/aprovuara me vendim nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) për kategoritë të sigurisë A, B, C dhe D, të cilat therrin gjedhë të identifikuar me matrikulë të Republikës së Kosovës, dhe trupi i therur i kafshës/gjedhit është kontrolluar dhe dëshmohet me vërtetim nga veterineri përgjegjës i autorizuar nga AUV.

#### **15.2. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.



### **15.3. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË APLIKUESIT / THERTORET:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të licencuara/aprovuara me vendim nga AUV për kategoritë të sigurisë A, B, C dhe D;
- Të raportojnë therjet në bazën e të dhënave në Sektorin e Identifikimit dhe Regjistrimit në AUV, sipas dinamikës së paraparë të thertores;
- Trupi i therur i kafshës/gjedhit duhet të kontrollohet dhe dëshmohet me vërtetim nga veterineri përgjegjës i autorizuar nga AUV;
- Gjedhet duhet të jenë të matrikuara me matrikulë të Republikës së Kosovës.

### **15.4. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për persona juridikë);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Regjistri i kafshëve të therura, i lëshuar nga baza e të dhënave të sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit - AUV, të dëshmuar me pasaportën e kafshës së therur;
- Vërtetimi-dëshmia e lëshuar nga veterineri përgjegjës i autorizuar nga AUV për realizimin e kontrollit të trupit të therur të kafshës/gjedhit.

### **15.5. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi bëhet për krerë gjedhi të therur të raportuar në vlerë prej 50 €/krerë.
- Pagesës në vlerë prej 50 €/krerë u bëhet thertoreve përfituese;

### **15.6. REALIZIMI I PAGESAVE PËR THERJET E RAPORTUARA TË GJEDHIT:**

Realizimi i pagesave direkte për therjet e raportuara të gjedhit, do të bëhet pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve sipas numrit të krerëve të gjedhëve të therura të nënshkruara nga veterineri përgjegjës i AUV, të verifikuar nga AZHB. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të aplikuesit- thertores.

### **15.7. THIRRJA PËR APLIKIM PËR PAGESA DIREKTE PËR THERJET E RAPORTUARA TË GJEDHIT:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të thertoreve për pagesa direkte për therjet e raportuara të gjedhit do të publikohet / shpallet çdo 6 (gjashtë) mujor dhe do të zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale përkatëse për Bujqësi.

## **15.8. ZBATIMI I PROGRAMIT:**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **16. PAGESAT DIREKTE PER SEKTORIN E AKUAKULTURËS**

Sektori i akuakulturës në Kosovë krahasuar me vendet e regjionit dhe të Evropës është i vogël edhe pse në vend ka resurse për zhvillimin e këtij sektori. Sipas të dhënave në vend prodhohen rreth 650 ton/vit mish i freskët i peshkut. Prodhimet kryesisht konsumohet në hoteleri dhe në treg si peshk i freskët.

Ekzistojnë 33 ferma (hurdha) të peshkut, nga të cilat vetëm njëra mbarështon llojin e peshkut Krap, ndërsa në 32 fermat (hurdhat) tjera mbarështohet lloji i peshkut Trofta. Nga fermat (hurdhat) që janë në prodhimtari aktive, 25 prej tyre prodhojnë për nevoja të hotelerisë, 8 janë me veprimtari të përzier hoteleri dhe plasman në treg.

Struktura e sektorit kryesisht dominohet nga fermat (hurdhat) e vogla që prodhojnë 10000 kg peshk/vit. Shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese vlerësohet se është rreth 50 %.

### **16.1. Objektivat e përgjithshme:**

- Përmirësimi i të hyrave në fermë;
- Rritja e madhësisë së fermës;
- Siguria e ushqimit.

### **16.2. Objektivat specifike:**

- Përmirësimi i cilësisë së prodhimeve;
- Shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese dhe rritja e numrit të fermave të reja;
- Rritja e prodhimtarisë dhe inkurajimi i procesit të përpunimit të peshkut;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;
- Rritja e furnizimit të tregut me prodhime të akuakulturës/peshk të freskët;

### **16.3. PËRFITUESIT:**

Përfitues do të jenë fermat të cilët mbarështojnë (prodhojnë) peshkun dhe që janë të regjistruar si biznes dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

### **16.4. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

### **16.5. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të shesin së paku 2500 kg peshk të freskët (peshku i gjallë, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temperatur +5°C i paketuar në vakum) brenda gjashtë (6) muajve, në Republikën e Kosovës ose jashtë vendit (eksport);
- Llojet e pranueshme të peshkut janë: Trofta dhe Krap;
- Të jenë të licencuar nga MBPZHR për zhvillimin e aktiviteteve në akuakulturë;

- Të jenë të regjistruar në AUV.

#### **16.6. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM;**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për persona juridikë);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Certifikata veterinare - shëndetësore e lëshuar nga Praktikat Veterinare të licencuara nga AUV;
- Dëshmi për sasinë dhe vendin e origjinës së ushqimit për peshk;
- Dëshmi nga ATK, për sasinë e shitur të peshkut të fresket (peshku i gjalle, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temp +5°C i paketuar në vakum).

#### **16.7. MËNYRA E SUBVENCONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për kg të peshkut të shitur, në vlerë prej 0.20 €/kg;
- Do të mbështeten (subvencionohen) të gjithë fermat - pronarët e hurdhave të peshkut që shesin së paku 2500 kg/peshk të fresket (peshku i gjalle, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temp +5°C i paketuar në vakum) brenda gjashtë muajve, në Republikën e Kosovës ose jashtë vendit (eksport).

#### **16.8. REALIZIMI I PAGESAVE PËR SEKTORIN E AKUAKULTURËS:**

Realizimi i pagesave do të bëhet pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve sipas sasisë së shitur të peshkut, të dëshmuar me dokument zyrtar të lëshuar nga ATK dhe të verifikuar nga AZHB. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të aplikuesve / subjekteve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

#### **16.9. THIRRJA PËR APLIKIM PËR PAGESA DIREKTE PËR SEKTORIN E AKUAKULTURËS:**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të subjekteve / aplikuesve për pagesa direkte për sektorin e akuakulturës do të publikohet / shpallet çdo gjashtë (6) mujor dhe do të zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale për Bujqësi

#### **16.10. ZBATIMI I PROGRAMIT:**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **17. PAGESAT DIREKTE PËR VIÇA PËR MAJMËRI**

Gjedhi është bartës i prodhimtarisë së mishit. Shkalla e vetëmjaftueshmerisë për mish të gjedhit është 52.2%. Fermat që mbarështojnë gjedhin janë furnizuesit kryesorë të industrisë së therrjes me krerë për therrje. Mishit i viçit është prodhimi më i kërkuar nga konsumatorët. Numri i fermave të specializuara për majmërinë e viçit është vazhdimisht në rritje. Sipas të dhënave numri i gjedhëve të therrur në vit është 116,048 krerë ndërsa nga popullacioni i gjedhit, në vit, vlersohet se për therrje, viça të moshës 0 - 2 vjeç, janë 98,225 krerë. Fermat e specializuara për majmërinë e viçit për therrje kryesisht furnizohen me viça të moshës deri 2 muaj, të cilët i nënshtrohen teknologjisë së majmërisë intenzive.

### **17.1. Objektivat e përgjithshme:**

- Përmirësimi i të hyrave në fermë;
- Rritja e madhësisë së fermës;
- Siguria e ushqimit.

### **17.2. Objektivat specifike:**

- Përmirësimi i cilësisë së prodhimeve;
- Shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese dhe rritja e numrit të fermave të reja;
- Rritja e prodhimtarisë dhe inkurajimi i procesit të përpunimit të mishit;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;
- Rritja e furnizimit të tregut me mish të freskët;

### **17.3 PËRFITUESIT:**

Përfitues do të jenë fermerët/subjektët që mbarështojnë viça për majmëri, të moshës nga 6 - 14 muaj dhe të cilët i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

### **17.4 SHTRIRJA GJEOGRAFIKE:**

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

### **17.5 KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë së paku 10 krerë viça për majmëri (meshkuj dhe femra) gjatë vitit kalendarik;
- Në kohën/ditën e aplikimit, mosha e viçave për majmëri duhet me qen nga 6 - 14 muaj;
- Viçat për majmëri duhet të jenë të matriculuara me matriculë të Republikës së Kosovës;
- Viçat për majmëri duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Numri i viçave për majmëri në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar;

#### **17.6 DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për persona juridikë);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Regjistri për vitin 2022, i lëshuar nga Praktikat veterinare të kontraktura nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur në të gjitha fletët/faqet;

#### **17.7 MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:**

- Subvencionimi do të bëhet për krerë -viça për majmeri, në vlerë prej 25 €/krerë;
- Përfitues do të jenë fermerët/ subjektet të cilët mbarështojnë së paku paku 10 krerë viça për majmeri, gjatë viti kalendarik, dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi;

#### **17.8. MËNYRA E APLIKIMIT**

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve/aplikuesve për pagesa direkte për viçat për majmeri do të publikohet/shpallet çdo gjashtë (6) muaj dhe do të zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale përkatëse për Bujqësi.

#### **17.9. REALIZIMI I PAGESAVE PËR VIÇAT PËR MAJMERI:**

Realizimi i pagesave do të bëhet pas kompletimit të dokumentacionit dhe hartimit të listave përfundimtare të përfituesve, sipas numrit të krerëve të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

#### **17.10. ZBATIMI I PROGRAMIT:**

Zbatimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

### Sqarim:

- Aplikuesi / fermeri pas aplikimit dhe para realizimit të kontrollit në teren, në rast se ka ndryshime në fermën e tij për sipërfaqet, numrin, litrat, kg dhe krerët e deklaruar gjatë aplikimit, duhet të informoj AZHB-në në adresën elektronike ndryshiminëfermë@azhb-ks.net ose me shkresë të protokolluar në arkiven e AZHB-së.
- Gjatë realizimit të kontrollit në teren nga AZHB, nëse aplikuesi ka ndryshime në fermën e tij për sipërfaqet, numrin, litrat, kg dhe krerët e deklaruar, aplikuesi /fermeri duhet të dëshmoi tek zyrtaret e kontrollit të AZHB-së për ndryshimin që i ka ndodhur në fermën e tij, me dokumentacion të lëshuar nga organi kompetent (Drejtoria komunale përkatëse për bujqësi, AUV, Policia e Kosovë), e që në rastet e tilla fermeri nuk e merr subvencionin, por as nuk duhet të ndërmerren masa sanksionuese ndaj fermerit kur e posedon dhe e ofron/deshmon dokumentacionin të lëshuar nga organi kompetent.
- Gjatë realizimit të kontrollit në teren për nensektorin e verërave dhe viçave për majmëri, duhet të merret në konsiderat se tek këta dy nënsektor ndryshimi i gjendjes për sasinë e litrave dhe numrin e viçave mund të ndryshoj në vazhdimësi prej momentit të aplikimit e deri në momentin e realizimit të kontrollit nga AZHB, si rezultat i shitjeve që mund të realizohen. Në rast se ka ndryshim, atëherë fermeri/aplikuesi/subjekti duhet të ofroj /paraqes si dëshmi faturat e rregullta të shitjes që ka realizuar mbas momentit të aplikimit dhe në këto raste litrat e vers se shitur dhe numri i viçave të shitur duhet të pranohen për subvencion.
- Në rast se kafshëve ju ka rënë ose ju ka humbur matrikula, atëherë fermeri duhet të paraqes kërkesë për matrikulim tek veterinari i autorizuar, e cila kërkesë duhet të jetë e nënshkruar dhe të ketë datën e parashtrimit të kërkesës, dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se 30 ditë. Kjo kërkesë e parashtruar nga fermeri me qëllim të rimatrikulimit, duhet të ofrohet/paraqitet në momentin e realizimit të kontrollit nga ana e AZHB-së, e që për rastet e tilla fermeri nuk e merr subvencion për ato kafshë, por as nuk duhet të ndërmerren masa sanksionuese ndaj fermerit për numrin e kafshëve që ju mungojn matrikulat por që e posedon si dëshmi kërkesën që ka paraqitur për rimatrikulim.
- Fermerët/aplikuesit, që përfitojn subvencionin për sipërfaqet e tokës bujqësore të mbjellurë/kultivuar, njëkohësisht do të përfitojn edhe nga subvencionimi i pjesëshëm i çmimit të naftës për litër, në vlerë prej 0.36 €/liter, për sasinë e naftës prej 150 l/ha e cila është e nevojshme për kultivimin e 1 ha të tokës bujqësore, dhe është vlerë shtesë mbi subvencionimin bazë për të gjitha sipërfaqet e tokës bujqësore që pranohen për subvencionim dhe që janë të parapara për tu subvencionuar në këtë program.
- Fermerët/aplikuesit, që përfitojn subvencionin për sipërfaqet e tokës bujqësore të mbjellurë/kultivuar me kulturat bujqësore: grur, miser, patate dhe fasule monokulturë, njëkohësisht do të përfitojn edhe nga subvencionimi i pjesëshëm për sasisën e plehut artificial të shpenzuar/përdorur gjatë kultivimit, në vlerë prej 150 €/ha për grur, ndërsa në vlerë prej 100 €/ha për miser, patate dhe fasule monokulturë dhe është vlerë shtesë mbi subvencionimin bazë për të gjitha sipërfaqet e tokës bujqësore të mbjellura/kultivuar, me kulturat bujqësore: grur, miser, patate dhe fasule monokulturë, të cilat pranohen për subvencionim dhe që janë të parapara për tu subvencionuar në këtë program.

**PS. Obligohet Departamenti i Politikave Bujqesore dhe Tregjeve, për hartimin e Udhëzimit Administrativ për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2022, për zbatimin e këtij programi.**